# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 11/186**
**Datë: 24.01.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Peshkatari dhe Akuakulturë.

2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeminister i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

# KONCEPT DOKUMENTI PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

Prishtinë 2023

# KONCEPT DOKUMENTI PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

**Hyrje** ... 4
**Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit** ... 6
**Kapitulli 2: Objektivat** ... 33
1. OBJEKTIVAT ... 33
**Mangësitë e identifikuara në sektorin e peshkatarisë mund të adresohen me tre opsione të ndryshme:** ... 43
**Kapitulli 3: Opsionet** ... 43
**3.1: Opsioni asnjë ndryshim** ... 43
**Peshkimi i paligjshëm, i parregulluar dhe i paraportuar** ... 49
**Peshkimi për qëllime kërkimore-shkencore** ... 50
**Peshkimi çlodhës - argëtues** ... 50
**Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme** ... 50
**Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi** ... 56
**Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme** ... 59
**Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me tri opsionet** ... 67
**Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm** ... 71
**Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin** ... 77
Shtojca 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik ... 78
Shtojca 2: Formulari i vlerësimit të ndikimit social ... 85
Aneksi 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit për të drejtat themelore ... 95

LISTA E SHKURTESAVE

| Akronimet | Kuptimi |
|---|---|
| **LPA** | Ligji për Peshkatari dhe Akuakulturë |
| **KE** | Komisioni Evropian |
| **AESU** | Autoriteti Evropian për Siguri të Ushqimit |
| **BE** | Bashkësia Evropiane |
| **MBPZHR** | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| **MMPHI** | Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës |
| **MKRS** | Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit |
| **AVU** | Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit |
| **FPSRK** | Federata e Peshkatarëve Sportivë-Rekreativë e Kosovës |
| **PKIMSA** | Programi Kombëtar për Implementimin e Marrëveshjes për Stabilizim - Asocim |
| **OBSHK /OIE** | Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve |
| **RKS** | Republika e Kosovës |
| **CFP** | Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Common Fisheries Policy) |
| **IUU** | Peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (ilegal, unraportet and unregulletet duhet te shihet origjinali) |
| **ZRPP** | Organizatë Rajonale e Menaxhimit të Peshkimit |
| **TAC** | Sasia totale vjetore të e peshkut të kapur e lejuar |
| **EMFF** | Fondin Evropian të Peshkimit Detar |
| **SFPA** | Peshkimin e Qëndrueshëm Marrëveshjet e Partneritetit |
| **MSA** | Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim |
| **GP** | Grupi punues |
| **PO** | Plani operacional |
| **LPPA** | Ligji për Procedurën e Përgjithëshme Administrative |

**Hyrje**

*Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin*

| | |
|---|---|
| Titulli | **Koncept Dokumenti për Peshkatarinë dhe Akuakulturë** |
| Ministria bartëse | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br>Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje<br>Divizioni i Blegtorisë |
| Personi kontaktues | Arsim Memaj 038/ 200 38 410 ; 044/ 183 572 |
| Plani Kombëtar për Zhvillim | - Qëllimi zhvillimor dhe qëllimi strategjik:<br>- Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë;<br>- Masa Strategjike: Përmbushja e kërkesave për ushqimin të sigurtë dhe të shëndetshëm.<br><br>Aktiviteti: Hartimi i Koncept Dokumentit për Peshkatari dhe Akuakulturë |
| Prioriteti strategjik | - Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025<br>2.10. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural<br>2.10.5 Siguria e ushqimit<br><br>- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030<br>Shtylla e I – Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik<br>Qëllimi Zhvillimor: Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese.<br>Qëllimi Strategjik: 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme mes fermerëve, përpunuesve e shitësve me pakicë.<br><br>**Objektivi strategjik:**<br>-Avancimi i politikave për zhvillimin e peshkatarisë dhe akuakulturës, të sigurisë ushqimore dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së.<br><br>**Objektivat specifike:**<br>- Integrimi i parimeve shkencore për zhvillimin e nënsektorit të peshkatarisë dhe akuakulturës, shëndetin e peshkut dhe vlerësimi i stoqeve dhe llojeve të peshkut në harmonizim me rregulloret e BE; |

| | |
|---|---|
| | - Përcaktimi i përgjegjësive të qarta për: Operatorët që merren me peshkim ekonomik, flotës për peshkim ekonomik, peshkatarët sportivë rekreativ, peshkëzimi i resurseve ujore dhe ruajtja e biodiversitetit, peshkimi hulumtues, mbarështimin e akuakulturës dhe raportimit të të dhënave dhe mirëmbajtjen e tyre për sasinë dhe llojet e peshkut në resurset ujore;<br><br>- Përgjegjësitë e operatorëve mbarështues të peshkut ose operatorëve që kapin / grumbullojnë peshkun për qëllime ekonomike në mënyrë që autoritetet kompetente të kenë bazën e të dhënave të përditësuar të ndërmarrjeve, aktiviteteve të tyre për sasinë e kapur/prodhuar dhe shtimin vjetor të peshkut;<br><br>-Përafrimi i politikave përmes harmonizimit të legjislacionit për peshkim ilegal, të pa raportuar dhe të pa rregulluar;<br><br>- Sistemi për njoftimin dhe raportimin e sasisë së peshkut të kapur dhe prodhuar sipas standardeve të BE;<br><br>- Baza ligjore për masat parandaluese dhe raportuese për mjetet dhe pajisjet për kapjen e peshkut dhe për mjetet dhe pajisjet e ndaluara për kapjen e peshkut. |
| Grupi punues | - Me Vendimin Nr. 118, Ref. ZSP. 148/23 i datës 28.02.2023, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZhR-së emëron Grupin Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Veterinarinë:<br>1. Arsim Memaj, Kryesues;<br>2. Fatmir Lahu, Zëvendës kryesues;<br>3. Albert Behrami, Anëtar;<br>4. Diturie Kryeziu, Anëtare;<br>5. Bafti Murati, AUV, Anëtar;<br>6. Fatmire Tahiri - Mirena, Anëtare;<br>7. Shuhrete Bunjaku, Anëtare;<br>8. Veton Çoçaj, Anëtar;<br>9. Leonora Arifi, Anëtare;<br>10. Merita Ramaxhiku, Anëtare;<br>11. Ekrem Ahmeti, Anëtar, SKQ/Zyra e Kryeministrit;<br>12.Valbona Fetahu, Anëtare, DL/Zyra e Kryeministrit;<br>13. Albulena Blaku, Anëtare, MF&T;<br>14. Përfaqsuesi i Federatës së Peshkatarëve Sportivë – Rekreativë (FPSRK) dhe<br>15. Agim Rexhepi Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, anëtar |

| | |
|---|---|
| Informata shtesë | Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian i vitit 2022, Kapitulli III Peshkataria, thekson:<br>•Rritja e përpjekjeve për të forcuar kapacitetet administrative për të siguruar përafrimin e duhur legjislativ për peshkatarinë;<br>• Harmonizimi i mëtejm i kontrollit të peshkimit dhe të akuakulturës, politikës së tregut dhe mbledhjes së të dhënave me sipas Acqui-s;<br>• Ngritja e kapaciteteve përmes TAIEX për metodologjinë e mbledhjes së të dhënave dhe avancimit të legjislacionit dhe politikave në peshkatari;<br>• Inventarizimi të llojeve të peshqve në një zonë pilot;<br>• Miratimi i Udhëzimit Administrativë "Mbrojtja e peshqve në ujërat e peshkimit". |

## Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

### 1.1. Situata në vendet e BE-së

BE-ja ka kompetencë ekskluzive për të menaxhuar ruajtjen e burimeve biologjike të resurseve ujore sipas Rregullores për Politikat e përbashkëta të peshkimit (CFP). Kjo vlen si në ujërat e BE-së ashtu edhe për përfshirjen e BE-së në dhe detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit dhe marrëveshje të tjera të Kombeve të Bashkuara në të cilat BE-ja është palë, të tilla si Marrëveshja OKB-së për rezervat e peshkut. BE-ja ka kompetencë ekskluzive për të menaxhuar Peshkimin e Qëndrueshëm Marrëveshjet e Partneritetit (SFPA) të lidhura ndërmjet BE-së dhe vendeve të treta.

Sipas Politikave të Përbashkëta të Peshkimit për menaxhim të qëndrueshëm, i bazuar në shkencë dhe inovacion publikuar në Bruksel, datë 21.2.2023, me emërtimin origjinal: "SWD (2023) 103 final/2, COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT, Common Fisheries Policy - State of play, Accompanying the document COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL The common fisheries policy today and tomorrow: a Fisheries and Oceans Pact towards sustainable, science-based, innovative and inclusive fisheries management" **(Politikës së përbashkët të peshkimit CFP).** Sipas **CFP** dhe siç është përcaktuar në nenin 49 të Rregullores së Përbashkët të Politikës së Peshkimit (BE), Nr. 1380/20131 ("Rregullorja CFP"), qëllimi është raportimi për funksionimin e politikës së përbashkët të peshkimit (CFP). Dokumenti vlerëson gjendjem dhe zbatimin e dispozitave të ndryshme, duke pasur parasysh sfidat dhe mundësitë, nga reforma e vitit 2013, orientimet politike të përcaktuara në Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, Biodiversiteti përkatës dhe strategjive për sigurinë e ushqimit "Farm to Fork". Në dokument trajtohet edhe ndikimi i krizës mjedisore (humbja e biodiversitetit, ndryshimet klimatike dhe ndotja), në menaxhimin e peshkimit dhe akuakulturës. Dokumenti shqyrton dinamikën e re në menaxhimin e peshkimit në BE dhe menaxhimin e stoqeve të peshkut me vendet e treta. Dokumenti bazohet në të dhënat e marra nga konsultimi me palët e interesuara dhe rezolutat e miratuara nga Parlamenti Evropian deri në

maj 2022, gjithashtu përmbanë edhe rekomandimet nga organe këshilluese shkencore, Komiteti për Peshkimin dhe Organizatave Rajonale të Menaxhimit të Peshkimit.

CFP përfshinë gjithashtu edhe kompetencat e përbashkëta ndërmjet BE-së dhe shteteve të saj anëtare për akuakulturën. Sipas CFP akuakultura ka vlerë të shtuar në BE-së dhe rekomandohen koordinim i veprimeve për të trajtuar pengesat për zhvillimin e qëndrueshëm te sektori në shtetet anëtare. Sipas politikës së tregut për peshkim dhe akuakulturë duhet të garantohet konkurrencë e ndershme për shtetet anëtare dhe bizneset, duke përfshirë organizatat e prodhuesve, për një shkallë të lartë autonomie në zbatimin e instrumente të politikave të tregut.

Qëllimi i reformës së CFP-së 2013 ishte eliminimi i mangësive të legjislacionit të mëparshëm kornizë siç përshkruhet në Dokumentin e Gjelbër të vitit 2009-14 e cila përmbanë kuadër ligjor gjithëpërfshirës për:

1. Objektivat mjedisore, ekonomike dhe sociale të peshkimit dhe mjetet për të menaxhuar këtë qasje;
2. Menaxhim të peshkimit me synim sigurimin e menaxhimit të stoqeve të peshkut me rendiment maksimal dhe të qëndrueshëm (MSY), për të siguruar që ndikimet negative të aktiviteteve të peshkimit në ekosistemin të minimizohen;
3. Detyrimi i raportimit të sasisë së peshkut / stoqeve;
4. Zbatimi i planeve shumëvjeçare për menaxhim të peshkimit specifik në nivelin e pellgut ujor;
5. Vëmendje ndaj faktorëve të jashtëm ambiental, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe parimet e CFP;
6. Vëmendjen ndaj akuakulturës, për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës në BE, duke përfshirë miratimin e udhëzimeve strategjike të Komisionit dhe detyrimi i shteteve anëtare për të miratuar planet strategjike kombëtare shumëvjeçare për sektorin;
7. Reformën e organizimit të përbashkët të tregjeve të peshkimit dhe akuakulturës, me theks në planet e prodhimit dhe marketingut të zhvilluara dhe zbatuar nga organizatat prodhuese;
8. Të fuqizuar Shtetet Anëtare për të bashkëpunuar në "rekomandimet përbashkëta” me masa specifike në nivelin e pellgut ujor;
9. Mundësitë e CFP-së dhe shfrytëzimin e njohurive dhe përvojave të të gjithë palëve të interesuara duke marrë parasysh kushtet e ndryshme në resurset ujore të BE-së dhe rritja e rajonalizimit të CFP;
10. Rol më të madh të shkencës, mbledhjen e të dhënave dhe këshillat shkencore;
11. Arritjen e ekuilibrit të qëndrueshëm ndërmjet kapaciteteve të flotës së peshkimit dhe peshkimit dhe mundësitë për të eliminuar kapacitetin e tepërt të flotës së peshkimit.

BE në Politikën e Përbashkët të Peshkimit (CFP) vëmendje të veqantë i ka kushtuar luftimit të peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të parregulluar (IUU) në ujërat e Komunitetit dhe në ato ndërkombëtare. Praktikat e e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të parregulluar (IUU) kërcënojnë dhe dëmtojnë qëndrueshmërinë e rezervave të peshkut, biodiversitetin e

ujërave, me fokus tek llojet e rralla dhe të kërcënuara të peshkut, ekosistemet e brishta dhe operatorët që merren me peshkatari të cilët respektojnë ligjin. Këto probleme ndërkombëtare kanë pasoja mjedisore, ekonomike dhe shoqërore.

**Acquis për peshkatari dhe akuakulturë**

Acquis për peshkatari dhe akuakulturë përbëhet nga një sërë rregulloresh, sipas të cilave kërkohet futja e masave për të lejuar administratën dhe operatorët për të zbatuar saktë Politikën e Përbashkët të Peshkimit (CFP).

Fushëveprimi, objektivat dhe parimet e CFP-së janë të përcaktuara në Bazë Rregullorja mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr 1380/2013). CFP parashikon rregulla për ruajtjen biologjike resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet. Gjithashtu përfshinë organizimin e tregut të përbashkët për peshkimin dhe produktet e akuakulturës, një politikë strukturore me fonde të dedikuara peshkimit, rregulla specifike për menaxhimin e kapacitetit të flotës së peshkimit, kontrollin e aktivitetit të peshkimit dhe zbatimin.

CFP promovon masa të bazuara në këshilla të shëndosha shkencore dhe ofron kornizën për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave të peshkimit. Menaxhimi specifik masat për shfrytëzimin e qëndrueshëm të peshkimit janë përcaktuar në Rregulloren (KE) Nr. 1967/2006 (Rregullorja e Mesdheut), ndërkohë që janë përcaktuar masa specifike për stokun dhe peshkimin nën kompetencën e Peshkimit Rajonal / Organizata e Menaxhimit. Rregulla specifike zbatohen gjithashtu për menaxhim disa rezervave, siç është ngjala evropiane (Rregullorja 1100/2007). Në lidhje me Menaxhimin e burimeve/stoqeve të peshkut dhe flotës, acquis përmban rregulla specifike për rregullimin e peshkimit, kapacitet për ekuilibër midis flotës dhe stoqeve si dhe për matjen e fuqisë së motorit dhe tonazhi i anijes. Nga shtetet anëtare kërkohet të mbledhin dhe përditësojnë të dhënat që lidhen me flotën e peshkimit, Rregullorja e Komisionit (KE) 26/2004.

Inspektimi dhe kontrolli janë kryesisht përgjegjësi e shteteve anëtare që kanë nevojë për të siguruar kapacitetin administrativ për zbatim efektiv, në përputhje me ligjin e BE-së kuadri i vendosur nga Rregullorja e Këshillit (KE) 1224/2009 e cila vendos ndër të tjera rregulla të hollësishme për regjistrimin, raportimin dhe monitorimin satelitor të anijeve. Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 përcakton dispozitat për Fondin Evropian të Peshkimit Detar (EMFF) për mbështetjen financiare për zbatimin e CFP, masat për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës. Për të përfituar nga EMFF, shteteve anëtare të BE-së u kërkohet të miratojnë dokument strategjik dhe programin operativ. Shtetet anëtare duhet të kenë gjithashtu kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për zbatim efikas të Planit Operacional (PO).

Acquis për tregun e peshkut, sipas Rregullores (BE) 1379/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe parashikon rregulla për organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacionet për konsumatorët, rregullat e konkurrencës dhe tregut.

Përveç rregullave të përgjithshme të ndihmës shtetërore, Acquis përmban rregulla specifike të ndihmës shtetërore të zbatueshme për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës. Duke pasur parasysh kompetencën ekskluzive në ruajtjen e burimeve biologjike ujore, BE-ja është palë me interes ndërkombëtar sipas marrëveshjeve dhe organizatave ndërkombëtarë.

Megjithëse është bërë përparim në kuadrin e planit të veprimit, peshkimi i IUU-së është larg nga çrrënjosja. Komisioni synon të vazhdojë monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive, identifikimin e operatororëve ilegal dhe zbatim më të mirë të rregullave dhe sanksioneve parandaluese për shkeljet. Sipas strategjisë, BE-së për të parandaluar dhe eliminuar peshkimin IUU ka miratuar rregulloret / legjislacioni lidhur me politiktat e BE-së: Rregullorja 1005/2008, datë 29 shtator 2008 për krijimin e një sistemi komunitar për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar, duke ndryshuar rregulloret (EEC) Nr 2847/93, (KE) Nr 1936/2001 dhe (EC ) Nr. 601/2004 dhe shfuqizimin e rregulloreve (EC), Nr. 1093/94 dhe (KE) Nr. 1447/1999 [OJ L 286, 29.10.2008]; Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 423/2004, e datë 26 shkurt 2004; Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 1342/2008 e datës 18 dhjetor 2008; Rregullorja e Këshillit (EU) Nr. 1243/2012 e datës 19 dhjetor 2012 që ndryshon Rregulloren (EC) Nr 1342/2008 për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e peshkimit; Rregullorja (EU) 2016/2094 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 nëntorit 2016 që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 1342/2008 për krijimin e Planit afatgjatë për rezervave dhe peshkimit që shfrytëzojnë ato rezerva.

## 1.2. Natyra dhe madhësia e sektorëve në fjalë në RKS

Sektori i peshkataris dhe akuakulturës në Kosovë, sipas të dhëna zyrtare, ka potencial për zhvillim më të hovshëm dhe me mundësi të arritjes së standardeve për ruajtjen e balancit ekologjik dhe shfrytëzimit të resurseve ujore.

Sipas të dhënave për Hidrografinë e Kosovës, "Raporti për gjendjen e natyrës 2010 -2014" përgatitur nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e natyrës / MMPHI, vlerësohet se Republika e Kosovës ka vetëm 1,600 $m^3$/ujë/vit për kokë banori, gjithnjë sipas vlerësimit janë të pa mjaftueshme.

Gjithashtu, sipas të njëjtit raport, hidrologjia e Republikës së Kosovës ndahet në 4 ( katër) pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçes dhe Lepenci. Nga territori i Republikës së Kosovës në vit rrjedhin përafërsisht 3.8 x 10 në fuqinë 9 ujë, përkatësisht 121.2 $m^3$/ sek. Shpërndarja e hidrologjike është jo e barabartë. Rezervat nëntokësore të ujit janë të kufizuara dhe kryesisht janë të përqendruara në pjesën perëndimore të vendit. Gjithashtu edhe numri i liqeve është po ashtu i vogël ndërsa liqene artificiale janë: Liqeni i Batllavës, Liqeni i Gazivodës, Liqeni i Radoniqit , Liqeni i Përlepnicës dhe Liqeni i Badovcit. Shfrytëzimi i këtyre liqeve bëhet për furnizim me ujë të pijes, nevoja të industrisë dhe ujitje në bujqësi megjithatë nuk nënvlerësohet potenciali i këtyre resurseve për zhvillimin e peshkatarisë.

Sipas të dhënave nga mbarështuesit / kultivuesit e peshkut në vend aktualisht prodhohen 700 ton / peshk në viti ndërsa, gjithnjë sipas të dhënave nga FPSRK, sasia e peshkut të kapur nga peshkatarët sportivë - rekreativë raportohet të jetë 200 ton.

**<u>Gjendja e peshkataris dhe akuakulturës</u>**

Zhvillimi i pershkatarsië në ujra të ëmla është i rregulluar me Ligjin për Peshkatari dhe Akuakultur Nr.02/L-85 dhe aktet nënligjore të nxjerra nga ky ligj.

Kosova ka një potencial të konsideruar të ujerave të ëmbla dhe me distanca relativisht të vogla me tregjet andaj zhvillimi i peshkatarisë dhe akuakulturës mund të siguroj mundësi të mëdha punësimi, profiti dhe mundësi tjera për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Sipas analizave të bëra nga MBPZHR duke pasur parasysh prodhimtarinë vendore të peshkut në hurdhat ekzistuese si dhe importin e peshkut të freskët dhe të ngrirë, konsumi i mishit të peshkut është 0.8 kg/banor, krahasuar me vendet e rajonit dhe më gjërë është nën çdo mesatare të konsumit duke patur parasysh se vendet e rajonit konsumojnë mesatarisht 3.0 kg/banor kurse vendet e Evropës (BE) rrethe 26 kg/banor.

Koncept dokumenti për peshkatarinë synon të përmirësojë ligjislacioni ekzistues duke reflektuar pritshmëritë e palëve të interesuara në ngritjen e efikasitetit për procedurat administrative me qëllim përafrimin e tyre me ato të BE-së gjithashtu, reflekton prioritetet e BE-së duke ndihmuar sektorin dhe menaxhimin e resurseve peshkore, rregulla për organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacionet për konsumatorët, rregullat e konkurrencës dhe tregut, përparim në peshkim IUU-së përmes identifikimit të operatororëve ilega dhe zbatim më të mirë të rregullave dhe sanksioneve parandaluese për shkeljet, fuqizimi i mekanizmave dhe efektiviteti në ruajtjen e resurseve dhe biodiversitetit të ihtiofaunës /peshqëve.

Resurset e ujërave sipërfaqësorë në Republikën e Kosovës janë të kufizuar, shfrytëzimi aktual i resurseve është i orientuar për konsum (pirje), ujitje të kulturave bujqësore dhe prodhimin e energjisë elektrike. Peshkataria aktualisht, marrë përsyshë resurset dhe cilësinë e ujërave është veprimtari në zhvillim e sipër për ekonomizim dhe aktualisht është vetëm në suaza të shfrytëzimit për peshkim rekreativë sportivë.

Peshkataria është sektorë me potencial për zhvillim pasi që Kosova disponon lumenj dhe liqej për mbarështimin e peshkut ne kushte intenzive. Në Kosovë peshkimi ekonomik nuk është i zhvilluar ndërsa peshkimi sportivo-rekreativ qëndron relativisht mirë. Deri më tani nuk është realizuar një inventarizim gjithëpërfshirës në resurset ujore të vendit tonë. Nga të dhëna me të cilat disponojmë inventarizimi gjithëpërfshirës në ujërat e Republikës së Kosovës deri më tani nuk është realizuar. Republika e Kosovës është nënshkruese e disa marrëveshjeve bilaterale me shtetet fqinje për resurset ujore dhe mbrojtjen e resurseve ujore dhe biodivesrsitetit.

Inventarizimi i resurseve peshkore si praktikë është shumë i domosdoshëm për të krijuar bazën e nevojshme të të dhënave për sasinë dhe llojin e peshqve, por edhe për orientimin e politikave zhvillimore, masave për ruajtjen e resurseve dhe biodiversitetit por gjithsesi edhe për përmbushjen e obligimeve që dalin nga marrëveshjet e nënshkruara nga Republika e Kosovës.

**Akuakultura -** Aktiviteti i akuakulturës në ujëra të ëmbla në Kosovë rregullohet bazuar në Ligjin për peshkatari dhe akuakulturë Nr.02 / L-85, dhe U/A Nr. 09/2008, për licencimin e aktiviteteve të akuakulturës.

Regjistrimi i prodhimtarisë në akuakultur është i rregulluar me Udhëzimin administrative për Licencimin e aktiviteteve në akuakultur sipas formularit të dhënë në Anexin – 4 të këtij udhëzimi.

Prodhimtaria e përgjithshme vjetore është rreth 1600 ton/vit të llojit Trofta ylber (Oncorhynchus mykiss). Madhësia e peshkut të gjallë dhe të përpunuar që tregtohet është rreth 350-400 gr.

Shumica e fermave të peshkut përdorin ujë direkt nga burimi, i cili siguron sasi të qëndrueshme dhe të cilësisë së mirë. Peshqit ushqehen me ushqim të peletuar, të cilat importohen nga vendet e BE -së (kryesisht Austria, Italia dhe Danimarka).

Sipas të dhënave janë 35 operatorë që merren me mbarështimin e peshkut nga të cilat 7 (shtatë) subjekte (ferma) janë të licencuara ndërsa të tjerat janë në kuadër të aktiviteteve të gastronomisë - furnizim intern.

Sa i përket prodhimit të peshkut, fermat e peshkut, sipas kapaciteteve prodhuese, mund të grupohen në katër kategori: 1. Prodhuesit me prodhim vjetor mbi 100 tonë (3 ferma), 2. Prodhuesit nga 50-100 ton (6 ferma), 3. Prodhuesit nga 20-50 ton (4 ferma) dhe 4. Prodhuesit nga 5-20 tonë në vit (13 ferma). Vetëm 1 (një) nga hurdhat, që është përfituese është femër.

Fuqia e punës dhe punësimi - Numri i vlerësuar i të punësuarve vetëm në kultivimin e peshkut, është rreth 120 punonjës me kohë të plotë, ose rreth një punonjës për 14 ton / peshk të prodhuar me një pagë mesatare prej 400 / € në muaj.

**Peshkimi sportiv-rekreativ**

Zhvillimi i peshkatarsië në ujëra të ëmla (lumej, liqej), është i rregulluar me Ligjin për Peshkatari dhe Akuakultur Nr.02/L-85 dhe Udhzimin administrative MA-NR.24/2007 për Peshkim Sportivo-Rekreativ dhe Mjetet dhe Paisjet për peshkim Sportiv-Rekreativ.

Federata e Peshkatarëve Sportiv - Rekreativ (FPSR), sipas legjislacionit në fuqi merr obligime në zbatimin e masave për mbrojtjen e fondit të peshkut duke ushtruar mandatin bazuar në Autorizimin e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Për mbrojtjen e peshkut nga ana e FPSR janë të angazhuar roje peshkimi.

Të gjithë peshkatret sportive-rekreativ qe mirren me gjuajtjen e peshkut sipas legjislacionit perkatës ne fuqi duhët të jan të pajisur me leje peshkimi, autorizimin per shtypjen dhe shprendarjen e lejeve e ka Federata e Peshkatareve Sporti-Rekreativ e Kosoves (FPSRK).

Peshkatari është i obliguar që pas përfundimit të peshkimit dhe largimit nga ujërat e peshkimit të shënoi të dhënat për sasinë dhe llojin e peshqve në regjistrin e regjistrimit të gjahut.Të dhënat nga peshkimi sportiv rekreativ të regjistruara në regjistër peshkatari është i obliguar t'i dorëzoi te shoqata ma së largu deri më datë 5 të muajit vijues

Me legjislacionin në fuqi regjistrat për regjistrimin e peshkut të kapur i shtypë dhe i shpërndan Federata e Peshkatareve Sportivo-Rekreativ (FPSR), përmbajtja e regjistrit është e rregulluar sipas anexit 4 të Udhëzimit Administrativ për peshkim sportiv-rekreativ.

Të dhënat nga regjistri i peshkimit sportiv rekreativ (sasinë dhe llojin), shoqata është i obliguar ti vejë në dispozicion Federatës deri më datë 10 të muajit vijues.Të dhënat nga regjistri i peshkimit sportiv rekreativ (sasinë dhe llojin), Federata është e obliguar ti vejë në dispozicion Ministrisë deri më 31 janar të vitit vijues për vitin paraprak.

**Kapacitetet teknologjike**: Me përjashtim të disa nga fermat e mëdha, Fermat janë kryesisht të pajisura dobët. Vetëm dy ferma peshku janë të pajisura me pajisje të lëngshme oksigjenimi, pompa transporti dhe makinë automatike të klasifikimit të peshkut. Katër ferma të peshkut përdorin aeratorë. Pothuajse e gjithë ushqyerja bëhet me dorë, dhe asnjë nga Fermat nuk ka një sistem alarmi automatik të cilësisë së ujit. Rezervuarët për shumëzimin e peshkut (vendet për klloçitje) nuk kanë pajisjet e duhura për nxjerrjen e vezëve.

Me teknologjinë e përmirësuar në procesin e prodhimit dhe bazuar në kapacitetet aktuale të mbarështimit, është e mundur të prodhohen rreth 2.000 tonë / peshk të llojit Trofta ylber në vit.

**Përpunimi**: Mungesa e objekteve të përpunimit mund të pengojë zhvillimin e mëtejshëm të sektorit. Meqenëse teknologjia e përpunimit po përmirësohet vazhdimisht. Aktualisht tre kompani kanë instaluar bazat e njësive të përpunimit që përfshijnë: Njësinë e vrasjes së peshkut, grykjen dhe filetimin manual, makinat e paketimit me vakum dhe hapësirë për ruajtje në të ftohtë. Megjithatë, për arritjen e standardeve sigurisë dhe cilësisë sipas sistemin e menaxhimit të sigurisë së ushqimit (HACCP), duhet të investohet në kapacitetet prodhuese dhe përpunuese.

**Konsumi -** Sipas të dhënave sasia e prodhuar e peshkut që nga fermat vendore tregtohet vetëm në nivel vendi. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se konsumi i përgjithshëm i produkteve të peshkut në Kosovë është afërsisht 1.4 kg për kokë banori. Rritja e konsumit bazohet në rritjen e prodhimit kombëtar dhe rritjen e produkteve të importuara të peshkut. Peshku kryesisht importohet si peshk i ngrirë - rreth 98 %. Sasia e importit të peshkut mesatarisht sillet të jetë rreth 1.200 ton/vit. Nën sektori i kultivimit të peshkut përmes pagesave direkte (subvencioneve) mbështet më 0.20 / € për kg të peshkut të shitur të deklaruar në Administratën Tatimore e Kosovës.

**<u>Mekanizmat e zbatimit të ligjit</u>**

MBPZHR në bashkëpunim me Federatën e Peshkatarëve Sportiv-Rekreativ të Kosovës (FPSRK) merr vendime për zonat e peshkimit, sasinë e peshkut për peshkim, pajisjet për peshkim etj. Përmes Federatës së Peshkatarëve vendimet barten në shoqatat lokale të peshkatarëve. Ndërsa sa i përket akuakulturës vendimet merren vetëm nga MBPZHR dhe si të tilla ekzekutohen nga Inspektorati.

Sipas legjislacionit në fuqi, licencimi nga lëmia e akuakulturës në shkallë vendi, është përgjegjësi e MBPZHR-së ndërsa licencimi i peshkatarëve për peshkim sportiv-rekreativ është kompetencë e deleguar në FPSRK. Federata e peshkatarëve sportivë organizon trajnime profesionale për peshkatarë dhe licencimin e tyre.

Kompetencat e Inspektorëve janë të përcaktuara në Ligjin për Peshkatarinë dhe akuakulturën nenet 51, 52, 53 dhe 54. Kompetencat e Rojeve të peshkimit janë përcaktuar në Ligjin për peshkatari dhe akuakulturë nenet 44, 45 dhe 46. Përgjegjësitë e inspektorëve për inspektim janë: Inspektimi i lejeve (licencave) për peshkim; Inspektimi i pajisjeve që përdoren në peshkim; Inspektimi i sasisë së peshkuar dhe Inspektimi i të gjithë aktiviteteve të akuakulturës.

Autorizimi për menaxhim të resurseve peshkore MBPZHR për çdo vit lëshon vendim për autorizimin e Federatës së Peshkatarëve Sportiv-Rekreativ për kufizimin e gjuajtjes së peshkut, dhënien e lejeve ditore dhe vjetore si dhe monitorimin e peshkimit.

## 1.3. Pasqyra e kornizës legjislative në RKS

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për zhvillimin e politikës për zhvillimin e peshkatarisë dhe akuakulturës, hartimin e legjislacionit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe legjislacionit në peshkatari dhe akuakulturë. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është organi ekzekutiv, përgjegjës për zbatimin e ligjislacionit për veterinarinë dhe ushqimin, me të cilat janë të rregulluar shëndeti i peshkut dhe prodhimeve akuatike dhe mbrojtja e shëndetit të konsumatorit.

Korniza aktuale ligjore e Kosovës për peshkatari dhe akuakulturë është e rregulluar me Ligjin Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, miratuar me 10 Tetor 2006 dhe një numër të akteve nënligjore që përcaktojnë zonat e peshkimit, peshkimin sportiv-rekreativ, pajisjet për peshkim, licencimin e akuakulturës dhe mbrojtjen e peshkut në periudhën e riprodhimit.

Që nga miratimi, Ligji për Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë nuk i është nënshtrua ndryshimeve. Bazuar në Ligjin Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë janë nxjerrë aktet nënligjore që rregullojnë çështje të peshkatarisë dhe akuakulturës: U/A Nr. MA-NO 24/2007 për peshkim sportiv– rekreativ dhe pajisjet për peshkim sportiv – rekreativ; U/A nr. MA-NO 09/2008 për licencimin e aktiviteteve të akuakulturës: U/A nr. MA-NO 07/2009 për përcaktimin e regjioneve – zonave të peshkimit dhe U/A (MBPZHR) – NR. 03/2022 për mbrojtjen e peshëve në ujërat e peshkimit.

| LEGJISLACIONI KOMBËTAR AKTUAL | LEGJISLACIONI RELEVANT I BE – SË | DOKUMENTET PLANIFIKUESE TË POLITIKAVE | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE | ROLET E INSTITUCIONEVE |
|---|---|---|---|---|
| Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë. | -Rregullorja (BE) Nr. 1380/2013 - Politika e Përbashkët e Peshkimit. | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025. | MBPZHR | Zhvillimi i politikës për peshkatari dhe akuakulturë, hartimi i ligjeve dhe zbatimit të legjislacionit për peshkatari dhe akuakulturë. |
| Ligji Nr. 02/L-85 për veterinari. | | Programi Kombëtar për Zbatimin e Stabilizim Asociimit 2021-2025. | AUV | Organi ekzekutiv përgjegjës për zbatimin e ligjislacionit për veterinarinë dhe ushqim. |
| Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyres. | Direktiva e KE për habitatet (92/43/EEC). | Srategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin. | MMPHI | Ruajtja e natyrës në baraspeshë ekologjike. |
| | -Rregulloren (EC) Nr 1342/2008 për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e peshkimit; | | Federata e Peshkatarëve sportivë – rekreativë e Kosovës (FPSRK). | Zbatimi i Autorizimit për peshkim sportivë –rekreativë. |
| | -Rregullorja (EU) 2016/2094 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 | | Fakulteti i Shkencave Matematikore – Natyrore dhe Fakulteti i | Zbatimi i studimeveve kërkimore |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Aktet nënligjore ne peshkatari dhe akuakulturë:<br>- U/A Nr. MA-NO 24/2007 për peshkim sportiv – rekreativ dhe pajisjet për peshkim sportiv – rekreativ;<br>-U/A nr. MA-NO 09/2008 për licencimin e aktiviteteve të akuakulturës:<br>-U/A nr. MA-NO 07/2009 për përcaktimin e regjioneve – zonave të peshkimit dhe<br>-U/A (MBPZHR) – NR. 03/2022 për mbrojtjen e peshëve në ujërat e peshkimit. | nëntorit 2016 që ndryshon<br><br>-Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 1342/2008 për krijimin e Planit afatgjatë për rezervave dhe peshkimit që shfrytëzojnë ato rezerva.<br>-Rregullorja EU No 508/2014 - Fondi Europian i Detarisë dhe Peshkimit (EMFF)<br>BE-së:<br>-Rregullorja (KE) Nr. 1967/2006 (Rregullorja e Mesdheut), ndërkohë që janë përcaktuar masa specifike për stokun dhe peshkimin nën kompetencën e Peshkimit Rajonal / Organizata e Menaxhimit.<br>-Rregulla specifike zbatohen gjithashtu për menaxhim disa rezervave, siç | | Bujqësisë dhe Veterinarisë. | shkencore në ekosistemin e resurseve ujore, Ihtiofaunë (speciet akuatike) dhe patologjitë e peshkut dhe specieve akuatike). |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | është ngjala evropiane.<br>-Rregullorja 1100/2007) Në lidhje me Menaxhimi i burimeve/stoqeve të peshkut dhe flotës, acquis përmban rregulla specifike për rregullimin e peshkimit kapacitet për ekuilibër midis flotës dhe stoqeve si dhe për matjen e fuqia e motorit dhe tonazhi i anijes.<br>Rregullorja e Komisionit (KE) 26/2004 për grumbullimin dhe përditësimin e të dhënave që lidhen me flotën e peshkimit.<br>-Rregullorja 1005/2008, datë 29 shtator 2008 për krijimin e një sistemi komunitar për parandalimin, parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | raportuar dhe të pa rregulluar. | | | |

*Tabela: Dokumentet legjislative dhe politike dhe përgjegjësitë e institucioneve*

Mënyra më e mirë për të përcaktuar mangësitë që dalin nga korniza aktuale ligjore e Kosovës është krahasimi me kornizën e re ligjore të BE-së për peshkatarinë dhe akuakulturën.

Krahasimi tregon se Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë përmban dispozita themelore për peshkatari dhe akuakulturë si: Peshkimin ekonomik përcakton zonat e peshkimit, peshkimin hulumtues për qëllime kërkimore – shkencore, peshkimin sportiv-rekreativ, pajisjet për peshkim, licencimin e akuakulturës, mbrojtjen e peshkut në periudhën e riprodhimit peshkimin hulumtues, peshkëzimin dhe mekanizmat e zbatimit dhe masat ndëshkimore për zbatimin e legjislacionit në peshkatari dhe akuakulturë. Megjithatë nuk ofron parimet e mjaftueshme horizontale të zhvillimit të peshkatarisë dhe akuakulturës dhe objektiva kryesore të politikës së peshkatarisë dhe akuakulturë për përafrimin e legjislacionit me Acu comunitare dhe Politikat e Përbashkëta për Peshkim të BE-së. Kjo do të thotë se masat ligjore janë të rregulluara me akte nënligjore, udhëzimeve administrative, që shpesh herë ka rezultuar me përzierje çështjesh horizontale dhe vertikale, siç është rasti e peshkimit ekonomik dhe peshkimit rekreativ-sportiv. Gjithashtu me ligjin aktual për veterinari dhe atë për ushqimin, përpos dispozitave themelore për shëndetin e kafshëve dhe ushqim ( duke përfshirë edhe ushqimin e kafshëve/peshkut), rregullohen praktikat mjekësore veterinare dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e institucioneve publike dhe personave individual në këtë fushë, duke përfshirë edhe shëndetin e peshkut dhe prodhimeve akuatike. Ligji aktual për veterinarinë dhe ushqimin përcakton përgjegjësinë e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë për shëndetin e peshkut dhe prodhimeve akuatike dhe kërkesat e sigurisë së ushqimit për këto prodhime.

Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë në krahasim me rregulloret e BE-së për peshkatarinë dhe akuakulturën ka disa zbrazëtira, ndër të cilat duhet të theksohet, si në vijim:

- Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet;

- 23 përkufizime / shprehjet e përdorura në ligjin aktual janë të pamjaftueshme për të kuptuar parimet e BE-së për peshkatari dhe akuakulturë për transpozimin dhe zbatimin e mëtejshëm të kornizës ligjore të BE-së. Për peshkatari dhe akuakulturë përcakton 110 përkufizime/shprehjet e përdorura kryesore të nevojshme;

- Nuk parashikohet menaxhimi specifik për masat e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit dhe stoqeve të peshkut;

- Rregullat specifike që duhet të zbatohen për menaxhimin e rezervave për  llojet e rralla apo të kërcënuara, siç është rasti i ngjala evropiane;

- Standardet për të dhënat dhe përditësimi i të dhënave për kapacitetin specifik-teknik të flotës së peshkimit;

- Nuk përmbanë rregullat për mbështetjen financiare për zbatimin e politikave të peshkimit, masat përkatëse në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës.

-Nuk përmbanë kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësinë e qasjes në fondet e EMFF të BE-së u;

- Nuk përmbanë kërkesat ligjore për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës, duke përfshirë miratimin e udhëzimeve strategjike të Komisionit dhe detyrimi i shteteve anëtare të BE-së për të miratuar planet strategjike kombëtare shumëvjeçare për sektorin (dokumentin strategjik) dhe programin operativ /operacional (PO);

- Nuk ofron bazën ligjore, sipas praktikave të shtetetve anëtare të BE-së për kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për zbatim efikas të PO;

- Nuk parashikon rregulla për organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe tregut për peshkun dhe prodhimet akuatike;

- Nuk ka të rregulluar sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar;

- Nuk ka bazë ligjore për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e peshkimit dhe peshkimit për shfrytëzimin e rezervave.

Korniza ligjore e Kosovës është e harmonizuar në mënyrë të pamjaftueshme me rregullat e BE-së dhe e fokusuar në mënyrë të pamjaftueshme në menaxhimin e rezervave të peshkut, planeve për rezervat e peshkut, biologjinë e peshkut, ndikimin e peshkimit në mjedis, regjistrimi i flotës së peshkimit dhe parandalimin e peshkimit ilegal dhe të pa raportuar. Korniza ligjore e Kosovës bazohet më tepër në qasjen e bazuar në kontrollin reaktiv që ofron përgjigje kur problemet ndodhin, prandaj si e tillë nuk ofron bazë ligjore për zbatimin e mbikëqyrjes.

Përgjithshisht, mund të thuhet se dispozitat e Ligjit për peshkatari dhe akuakulturë në krahasim me rregulloret e BE-së për peshkatari dhe akuakulturë janë shumë të thjeshtuara, jo të plota dhe nuk janë adekuate për të ofruar kuptim të plotë të legjislacionit të BE-së për peshkatari dhe akuakulturë. Dispozitat e legjislacionit aktuale, janë gjithashtu, të pamjaftueshme për

transpozimin e legjislacionit dytësor të përafruar me Acquis të BE-së në peshkatari dhe akuakulturë.

Meqenëse ndikimi i sëmundjeve të peshkut dhe masat e nevojshme për të kontrolluar ato sëmundje mund të jenë shkatërruese për popullatat e peshkut, mbarështuesit dhe ekonomitë që merren me menaxhimin e peshkut kanë ndikim të rëndësishëm në shëndetin publik dhe sigurinë ushqimore, qasja e harmonizuar për shëndetin e peshkut është thelbësore për të siguruar mbrojtjen e duhur. Me globalizimin dhe rritjen e tregtisë së peshkut dhe produkteve të peshkut rritet rreziku i përhapjes së sëmundjeve dhe kjo reflektohet edhe në tregun vendor.

Në terma shumë të përgjithshëm, shëndeti i mirë i peshkut gjeneron jo vetëm përfitime për mbarështuesit dhe operatorët, por është e mirë publike / shoqërore.

Rëndësia e përafrimit të legjislacionit me Acqui-në e BE-së dhe ngritja e kapaciteteve për zbatimin e ligjit janë përcaktuar me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, e hyrë në fuqi më 1 prill 2016. MSA-ja përfaqëson marrëdhënien e parë kontraktuale gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe BE-së dhe është moment historik i rëndësishëm në procesin e integrimit Evropian të Kosovës. MSA ka vendosur në dispozita kontraktuale detyrimin për zbatimin e masave për peshkatarinë dhe shëndetin e kafshëve si një nga hapat kyç drejt anëtarësimit në BE-së.

Krahas obligimeve nga MSA-ja, Kosova duhet të përmbushë edhe kërkesat që dalin nga Raportet Vjetore të KE-së për Kosovën. Dy raportet e fundit, për vitin 2020 dhe 2021, kanë theksuar vazhdimisht peshkatarinë si një nga kërkesat për përmbushjen e obligimeve të MSA. Sipas raporteve të përmendura, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet hartimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e plolitikave dhe legjislacionit në harmonizim prandaj edhe harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së me miratimin e kornizës së re ligjore për peshkatari dhe akuakulturë, dhe ofrimi i shërbimeve publike për palët me interes vlerësohet si një nga prioritet për Kosovën.

**Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore**

| **Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor** | **Lidhja (linku) me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni (-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim** | **Roli dhe detyrat e Institucionit (-eve)** |
|---|---|---|---|
| **Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë** | **https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2476** | MBPZhR<br><br>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinaris; | Mbikqyrja e zbatimit të Ligjit për peshkatari dhe akuakulturë.<br><br>- Mbrojtjen e shëndetit të peshkut dhe kulturave akuatike<br><br>- Mbrojtjen e shëndetit publik,<br>-Kontrollës zyrtare të mishit dhe prodhimeve të peshkut dhe prodhimeve akuatike |
| **Ligji Nr. 2004/21 për veterinari** | **https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2476** | MBPZhR<br><br>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinaris; | Mbikqyrja e zbatimit të Ligjit për veterinari.<br><br>- Mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve,<br>- Mbrojtjen e shëndetit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | publik,<br>-Kontrollës zyrtare dhe<br>-Mbikëqyrjes veterinare. |
| **Ligji Nr.03/L-016 për ushqimin** | **https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61467** | MBPZhR<br><br>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinaris dhe Komunat | Mbikqyrja e zbatimit të Ligjit për ushqimin.<br><br>-Kërkesat që kanë të bëjnë me higjienën e ushqimit dhe ushqimin e sigurte për njerëz si dhe ushqimin për kafshë;<br>- Obligimet e subjekteve që afarojnë me ushqim për njerëz dhe me ushqim për kafshë<br>sa i përket higjienës dhe ushqimit të sigurte për njerëz dhe ushqimit për kafshë;<br>- Sistemi i kontrollit zyrtar i ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë dhe<br>- Menaxhimi me krizat dhe me rastet emergjente. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Ligji Nr.03/L-029 për Inspekcionin Bujqësor** | **https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=xxxx** | MBPZhR | Mbikqyrja e zbatimit të Ligjit për peshkatari<br><br>Mbikqyrja e zbatimit të Ligjit përmes inspektorëve |
| **Ligji Nr.04 /L-147 për ujërat e Kosovës** | **https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8659** | MMPHI | Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit per ujërat dhe legjislacionit sekundar |
| **Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit** | **https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=xxxx** | MMPHI | Mbrojtja e resurseve ujore dhe mjedisit në përgjithsi |
| **Ligji Nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës** | **https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=xxxx** | MMPHI | Mbrojtja e biodiversitetit të florës dhe faunës. |
| **Ligji Nr.05/L-087 për Kundërvajtje** | **https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=xxxx** | MBPZhR<br><br>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinaris | -Harmonizimi i dispozitave ndëshkimore të Ligjit për peshkatari dhe akuakulturë dhe legjislacionit për veterinari dhe të ushqimit, me dispozita ndëshkimore |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | të Ligjit për Kundërvajtje |
| **Ligji i Emergjencave** | **https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=xxxx** | MPB | Mexhaxhimi i situatave emergjente dhe rasteve të katastrofave ekologjike siç mund të jenë ngordhjet masive të peshkut dhe specieve të akuatike. |

*Si në shembullin e mëposhtëm duhet të plotësohet problemi kryesor, shkaqet dhe efektet si dhe për të elaborohen veç e veç:*

*Problemi kryesor, shkaqet dhe efektet*

**Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet**

| | |
|---|---|
| **Efektet** | **Rregullat nuk zbatohen siç duhet**<br><br>Korniza ligjore e Kosovës për peshkatari, Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, nuk është e harmonizuar me rregullat e BE-së.<br><br>- Çrregullimi i ekosistemit dhe humbja ekonmike;<br>- Shërbime jo të koordinuara për monitorimin e shëndetit të peshkut;<br>- Peshkimi ilegal i pa- raportuar dhe pa-rregullluar;<br>- Të dhëna jo të qëndrueshme për popullacionit të peshkut dhe probleme me mirëmbajtjen e të dhënave statistikore;<br>- Humbja e fondeve për investime në peshkatari; |
| **Problemi kryesor** | **Avancimi i infrastrukturës ligjore për Peshkatari dhe Akuakulturë në harmoni me atë të BE-së** |
| **Shkaqet** | **Rregullat nuk janë të zbatueshme siq kërkohet :** |

| | |
|---|---|
| | Korniza aktuale ligjore e Kosovës për peshkatari dhe akuakulturë, miratuar në vitin 2006 dhe nuk i është nënshtrua ndryshimeve, është e pa kompletuar sipas rregulloreve të BE-së.<br>- Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike të resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit;<br>- Mbikqyrja e zbatimit të legjislacionit për peshkatarinë dhe akuakulturën;<br>- Mungesa e inspektorëve të blegtorisë dhe peshkatarisë përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit;<br>- Vleresimi i stoqeve të peshkut dhe statistikat sektoriale;<br>- Mungesa e përkrahjes nga BE, për zbatimin e politikave të peshkimit; |
| | **Rregullat janë të pakompletuara:**<br>- Për menaxhimin e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara ( rasti ngjala evropiane);<br>- Për standardet e raportimit të të dhënave dhe përditësimi të tyre për stoqet e peshkut dhe akuakulturës;<br>- Për standardet e raportimit të të dhënave dhe përditësimi të tyre për kapacitetin specifik të flotës së peshkimit;<br>- Nuk ka të rregulluar sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar;<br><br>**Mangësitë në kornizën aktuale ligjore për peshkatarinë dhe akuakulturën:**<br>- Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet;<br>- 23 përkufizime / shprehjet e përdorura në ligjin aktual janë të pamjaftueshme për të kuptuar parimet e BE-së për peshkatari dhe akuakulturë për transpozimin dhe zbatimin e mëtejshëm të kornizës ligjore të BE-së. Për peshkatari dhe akuakulturë përcakton 110 përkufizime/shprehjet e përdorura kryesore të nevojshme;<br>- Nuk parashikohen menaxhimi specifik për masat e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit dhe stoqeve të peshkut;<br>- Rregulla që duhet të zbatohen për menaxhimin e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara, siç është rasti i ngjala evropiane;<br>- Standardet për të dhënat dhe përditësimi i të dhënave për kapacitetin specifik-teknik të flotës së për peshkimit; |

| | |
|---|---|
| | - Nuk përmbanë rregullat për mbështetjen financiare për zbatimin e politikave të peshkimit në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës.<br>-Nuk përmbanë kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësinë e qasjes në fondat e EMFF të BE-së;<br>- Nuk përmbanë kërkesat ligjore për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës, duke përfshirë miratimin e planit strategjik kombëtar shumëvjeçar për sektorin;<br>- Nuk ofron bazën ligjore, sipas praktikave të shtetetve anëtare të BE-së për kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për zbatim efikas të OP.<br>- Nuk parashikon rregulla për organizatat profesionale;<br>- Nuk parashikon rregulla për standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe tregut për peshkun dhe prodhimet akuatike.<br>- Nuk ka të rregulluar sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar;<br>- Nuk ka bazën ligjore për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e resurseve peshkore;<br>- Sa i përket ofrimit të shërbimeve, këto mangësi konsistojnë në:<br>mos-kompletimi i legjislacionit sekondar për të gjitha shërbimet publike;<br>zbatimi i ofrimit të lejeve për peshkim rekreativ përmes OJQ, paraqet probleme sa i përket menaxhimit të shërbimeve nga ana e organit të administratës publike; kërkesat për informacion nuk janë në linjë me LPPA, sidomos sa i takon informacionit që ndërlidhet me certifikatën e regjistrimit të biznesit, lejeve ndërtimore, kontrollimi i cilësisë së ujit etj; afatet e ofrimit të shërbimeve, nuk janë në përputhje me LPPA, pasiqë nuk janë caktuar afate për shqyrtim apo për ankimim gjithashtu, sa i takon taksave dhe tarifave, nuk është e qartë se si ato plotësojnë kërkesat e LPPA për mos-pagesën. |

*SHKAQET E PROBLEMIT*

**Rregullat nuk janë të zbatueshme siq kërkohet**

Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 10 Tetor 2006 përmban dispozita themelore për peshkatari dhe akuakulturë. Me këtë ligj janë rregulluar peshkimi ekonomik, zonat e peshkimit, peshkimi hulumtues për qëllime kërkimore – shkencore, peshkimi sportiv-rekreativ, pajisjet për peshkim, licencimin e akuakulturës, mbrojtjen e peshkut në periudhën e riprodhimit peshkimin hulumtues, peshkëzimin dhe mekanizmat e zbatimit dhe masat ndëshkimore për zbatimin e legjislacionit në peshkatari dhe akuakulturë.
Ligji aktual për peshkatari dhe akuakulturë, krahasuar me rregulloret e BE-së nuk përmbanë parimet e mjaftueshme horizontale të zhvillimit të peshkatarisë dhe akuakulturës dhe objektiva kryesore të politikës së peshkatarisë dhe akuakulturë për përafrimin e legjislacionit me Acu comunitare dhe PP për peshkim të BE-së, Rregullorja mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr 1380/2013).
Disa nga masat ligjore janë të rregulluara me akte nënligjore, udhëzimeve administrative, që shpesh herë ka rezultuar me përzierje çështjesh horizontale dhe vertikale, siç është rasti e peshkimit ekonomik dhe peshkimit rekreativ-sportiv, përgjegjësitë e institucione për menaxhimin e resurseve ujore dhe biodivesritetit gjë që ka rezultuar me pa qartësi në vendimmarrje dhe adresimin e problemeve dhe përgjegjësive.
Me ligjin aktual për veterinari dhe ushqim, përpos dispozitave themelore për shëndetin e kafshëve dhe ushqim ( duke përfshirë edhe ushqimin e kafshëve/ peshkut dhe shëndetin e peshkut), po ashtu janë evidente aktivitetet paralele në zbatimin e legjislacionit dhe në procedura. Ligji aktual për veterinarinë dhe ushqimin përcakton përgjegjësinë e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë për shëndetin e peshkut dhe prodhimeve akuatike dhe kërkesat e sigurisë së ushqimit për këto prodhime. Me ligjin për veterinarinë rregullon praktikat mjekësore veterinare për shëndetin e kafshëve dhe të peshkut dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e institucioneve publike dhe personave fizik në këtë fushë duke përfshi edhe shëndetin e peshkut dhe prodhimeve akuatike dhe për këto përgjegjësi ka rezultuar se nuk ka pasur koordinim me institucionet përgjegjëse për menagjimin e resurseve ujore dhe politikëberëse për peshkatari. Dispozitat e Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë e Kosovës krahasim me Ligjin e BE-së për Shëndetin e Kafshëve janë shumë të thjeshtuara, të vjetruara, jo të plota dhe nuk janë adekuate për të ofruar interpretim të plotë të legjislacionit të BE-së për shëndetin e kafshëve dhe aktualisht është në procedurë për hartimin e Projekt ligjit të ri për veterinarinë/ shëndetin e kafshëve.

**Administrimi dhe menaxhimi jo i drejtë dhe jo i qëndrueshëm i resurseve peshkore dhe akuakulturës**

Me ligjin aktual për peshkatari nuk parashikohet menaxhimi specifik për masat e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit dhe stoqeve të peshkut, menaxhimi e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara (Rregullorja (KE) Nr. 1967/2006, ndërkohë që janë përcaktuar masa specifike për stokun dhe peshkimin nën kompetencën e Peshkimit Rajonal / Organizata e Menaxhimit, siç

është rasti i ngjala evropiane, nuk përmbanë rregullat për mbështetjen financiare për zbatimin e politikave të peshkimit në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës, nuk përmbanë kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësinë e çasjes në fondet e EMFF të BE-së (Rregullorja BE), Nr. 508/2014 përcakton dispozitat për Fondin Evropian të Peshkimit Detar (EMFF) për mbështetjen financiare për zbatimin e CFP, nuk ofronë bazën ligjore, sipas praktikave të shtetetve anëtare të BE-së për kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për zbatim efikas të PO gjithashtu nuk parashikon rregulla për organizatat profesionale, për standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe tregut për peshkun dhe prodhimet akuatike (Rregullores BE), 1379/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe parashikon rregulla për organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacionet për konsumatorët, rregullat e konkurrencës dhe tregut), dhe nuk ka të rregulluar sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar (Rregullorja 1005/2008, datë 29 shtator 2008 për krijimin e një sistemi komunitar për parandalimin, parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar).

**Rregullat janë të pakompletuara**

Disa nga rregullat në peshkatari dhe akuakulturë, të cilat nuk janë të kompletuara me legjislacion, është bërë përpjekje që të rregullohen me akte nenligjore. Bazuar në legjislacionin për peshkatari dhe akualturë është rregulluar raportimi i të dhënave nga sasia e peshkut të kapur nga peshkimi sportivë – rekreative nga peshkatarët e licencuar për peshkim sportivë rekreativë, raportim ky i deleguar në shoqata lokale dhe në nivel të FPSRK. Gjithashtu edhe operatorët e licencuar për zhvillimin e aktiviteteve në akuakulturë janë të obliguar të deklarojnë stoqet e peshkut dhe prodhimtarinë në baza vjetore. Megjithatë me ligjin aktual për peshkatari nuk është rregulluar menaxhimi i rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara ( rasti ngjala evropiane) gjithashtu në legjislacionin aktual nuk është e kompletuar baza ligjore për standardet e raportimit të të dhënave dhe përditësimi të tyre për stoqet e peshkur dhe akuakulturës; për standardet e raportimit të të dhënave dhe përditësimi të tyre për kapacitetin specifik të flotës së peshkimit dhe nuk ka të rregulluar sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar.

Sa i përket aspekteve administrative, legjislacioni është i pakompletuar për disa shërbimet dhe nuk është në linjë me kërkesat e LPPA për proporcionalitet, pasiqë kërkon informacion voluminoz nga pala, përfshirë informacionin që është në dispozicion të organeve të administratës publike. Për më tepër, afatet në legjislacionin për peshkatari dhe akuakulturë, nuk janë në përputhje me kërkesat e LPPA. Taksat dhe tarifat për ofrimin e shërbimeve, gjithashtu janë në shpërputhje me kërkesat e mospagesës gjithashtu edhe procedura e ankimimit nuk plotëson kërkesat e ligjit të përmendur.

## EFEKTET E PROBLEMIT

### Rregullat nuk zbatohen siç duhet

Korniza aktuale ligjore e Kosovës për peshkatari dhe akuakulturë dhe përgjithësisht fusha peshkatarisë sipas Ligjit Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, e miratuar më 10 Tetor 2006 dhe një numër i akteve sekondare legjislative që përcaktojnë parimet horizontale dhe ato vertikale për peshkatari dhe akuakulturë megjithatë legjislacioni aktual nuk ka të kompletuar bazën ligjore, sipas rregulloreve të BE për çështjet në vazhdim:

- Nuk ofron parimet e mjaftueshme horizontale të zhvillimit të peshkatarisë dhe akuakulturës dhe objektiva kryesore të politikës së peshkatarisë dhe akuakulturë për përafrimin e legjislacionit me Acu comunitare dhe PP për peshkim të BE-së, Rregullorja mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr 1380/2013);
- Disa nga masat ligjore janë të rregulluara me akte nënligjore, udhëzimeve administrative, që shpesh herë ka rezultuar me përzierje çështjesh horizontale dhe vertikale, siç është rasti e peshkimit ekonomik dhe peshkimit rekreativ sportivë, përgjegjësitë e institucione për menaxhimin e resurseve ujore dhe biodivesritetit gjë që ka rezultuar me pa qartësi në vendimmarrje dhe adresimin e problemeve dhe përgjegjësive.
- Ligji aktual për veterinarinë dhe ushqimin përcakton përgjegjësinë e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë për shëndetin e peshkut dhe prodhimeve akuatike dhe kërkesat e sigurisë së ushqimit për këto prodhime. Dispozitat e Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë e Kosovës krahasim me Ligjin e BE-së për Shëndetin e Kafshëve janë shumë të thjeshtuara, të vjetruara, jo të plota dhe nuk janë adekuate për të ofruar interpretim të plotë të legjislacionit të BE-së për shëndetin e kafshëve dhe aktualisht është në procedurë për hartimin e Projekt ligjit të ri për veterinarinë;
- Nuk përmbanë rregullat për mbështetjen financiare për zbatimin e politikave të peshkimit në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës, nuk përmbanë kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësin ë e çasjes në fondat e EMFF të BE-së;
- Nuk është e kompletuar baza ligjore për standardet e raportimit të të dhënave dhe përditësimi të tyre për stoqet e peshkur dhe akuakulturës;
- Nuk është rregulluar menaxhimi i rezervave për speciet e veqanta;
- Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet;
- 23 përkufizime / shprehjet e përdorura në ligjin aktual janë të pamjaftueshme për të kuptuar parimet e BE-së për peshkatari dhe akuakulturë për transpozimin dhe zbatimin e mëtejshëm të kornizës ligjore të BE-së;
- Nuk parashikon rregulla për organizatat profesionale;
- Nuk parashikon rregulla për standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe tregut për peshkun dhe prodhimet akuatike;

- Nuk ka të rregulluar sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar;
- Për krijimin e një sistemi komunitar për parandalimin, parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar).

**Palët me interes**

*Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit*

| **Emri i palës së interesuar** | **Shkaku/qet me të cilat është e lidhur pala** | **Efekti/et me të cilat është e lidhur pala** | **Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)** |
|---|---|---|---|
| MBPZHR | - Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike te resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit;<br>- Mbikqyrja e zbatimit të legjislacionit për peshkatarinë dhe akuakulturën;<br>- Mungesa e inspektorëve të blegtorisë dhe peshkatarisë përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit;<br>- Vleresimi i stoqeve te | - Çregullimi i ekosistemit dhe humbja ekonomike;<br>- Shërbime jo të koordinuara për monitorimin e shëndetit të peshkut;<br>- Peshkimi ilegal i pa- raportuar dhe pa- rregullluar;<br>- Të dhëna jo të qëndrueshme për popullacionit të peshkut dhe probleme me mirëmbajtjen e të dhënave statistikore;<br>- Humbja e fondeve per | MBPZhR është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit dhe mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit për peshkatari dhe akuakulturë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | peshkut dhe statistikat sektoriale;<br>- Mungesa e përkrahjes nga BE, për zbatimin e politikave të peshkimit; | investime ne peshkatari; | |
| Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV) | - Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike te resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit; | - Shërbime jo të koordinuara për monitorimin e shëndetit të peshkut;<br>- Të dhëna jo të qëndrueshme për popullacionit të peshkut dhe probleme me mirëmbajtjen e të dhënave statistikore; | AUV është përgjegjëse zbatimit të legjislacionit për veterinarinë dhe ushqimin me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe cilësinë e prodhimeve të peshkut. |
| Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) | - Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike te resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit; | - Çregullimi i ekosistemit dhe humbja ekonomike;<br>- Peshkimi ilegal i pa- raportuar dhe pa- rregullluar;<br>- Të dhëna jo të qëndrueshme për popullacionit të peshkut dhe probleme me | Minitorimi i popullacioneve të peshkut, raportimi i të dhënave nga peshkimi i lejuar dhe raportimi i rasteve të patologjive në resurset ujore të zonave malore. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | mirëmbajtjen e të dhënave statistikore; | |
| Departamenti për mbrojtjen e mjedisit dhe ujërave / MMPHI | - Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike te resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit;<br><br>- Vleresimi i stoqeve te peshkut dhe statistikat sektoriale; | - Çregullimi i ekosistemit dhe humbja ekonomike;<br>- Peshkimi ilegal i pa- raportuar dhe pa- rregullluar;<br>- Të dhëna jo të qëndrueshme për popullacionit të peshkut dhe probleme me mirëmbajtjen e të dhënave statistikore; | Sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit.<br><br>- Siguronë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi.<br><br>-Përcaktoë strukturat institucionale për administrimin e resurseve ujore. |
| Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) | - Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike te resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit; | - Peshkimi ilegal i pa- raportuar dhe pa- rregullluar; | Siguron zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetetit;<br><br>Monitoron gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë: ajrin, tokën, ujin, llojllojshmërinë biologjike etj. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | ndryshimet klimatologjike); |
| Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës | - Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike te resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit; | - Çregullimi i ekosistemit dhe humbja ekonomike;<br>- Shërbime jo të koordinuara për monitorimin e shëndetit të peshkut; | Monitoron të reshurat atmosferike, ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të nëntokës të burimit të parë dhe tokës, studimi dhe prognozimi i kushteve hidrometeorologjike të ndotjes së mjedisit. |
| Federata e Peshkatarëve Sportivë – Rekreativë e Kosovës (FPSRK) | - Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike te resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit; | - Çregullimi i ekosistemit dhe humbja ekonomike;<br>- Të dhëna jo të qëndrueshme për popullacionit të peshkut dhe probleme me mirëmbajtjen e të dhënave statistikore; | Shërbime profesionale në peshkimin sportivë - rekreativë dhe mbrojtjen e resurseve peshkore nga peshkimi ilegal sipas mandatit të deleguar me legjislacion tek përdoruesit e shërbimeve. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Deparatamenti i Biologjisë / Fakulteti i Shkencave Matematikore Natyrore | - Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike te resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit; | - Shërbime jo të koordinuara për monitorimin e shëndetit të peshkut; | - Vlerësimi shkencorë i stoqeve të peshkut biodiversitetit të popullacionit të peshkut dhe organizmave tjerë ujorë. |
| Departamenti i Semundjeve te Kafsheve / Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë | - Fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike te resurseve ujore si dhe kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit; | - Çregullimi i ekosistemit dhe humbja ekonomike;<br>- Shërbime jo të koordinuara për monitorimin e shëndetit të peshkut; | - Vlerësimi shkencorë i shëndetit në stoqet e peshkut dhe organizmave tjerë ujorë në resurse ujore dhe akuakulturë. |

**Kapitulli 2: Objektivat**

*Objektivat relevante të Qeverisë*

1. OBJEKTIVAT

Siç është paraparë nga MSA-ja, Kosova ka zhvilluar Programin Kombëtar për Zbatimin e Stabilizim Asocimit (PKZMSA), si një dokument kryesor strategjik kombëtar për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe fazat e ardhshme të anëtarësimit në BE. PKZMSA për vitet 2021-2025 përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse afatmesëme të të gjitha reformave të kërkuara për të përmbushur detyrimet që dalin nga MSA, përkatësisht masat dhe prioritetet e kërkuara për përafrimin gradual të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-

së, duke e transpozuar këtë të fundit në legjislacionin kombëtar, dhe zbatimin e legjislacionit të përafërt, gjithashtu me rekomandimet e dhëna, çdo vit, nga raportet e KE-së, Nënkomiteti për Bujqësi dhe Peshkim, Kapitulli 13- Peshkataria.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 - 2025 është dokumenti bazë përmes të cilit Qeveria ua komunikon vizionin qytetarëve të Republikës së Kosovës në lidhje me qeverisjen e saj. Ai pasqyron qasjen dhe parimet që duhen ndjekur gjatë gjithë qeverisjes, si dhe prioritetet dhe nismat bazë që do të ndërmerren në të gjitha fushat për përmirësimin e situatës në vend. Ky program pasqyron orientimet e përgjithshme në lidhje me agjendën e integrimit evropian dhe politikën e jashtme. Ai transmeton frymën demokratike dhe pluraliste të vendit, e cila siguron përfundimin e procesit të shtet ndërtimit dhe integrimin e plotë të Republikës së Kosovës në institucionet rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Sipas Programit Qeveritar 2021-2025 objektivi është avancimi i politikave dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë në këtë drejtim, prioritet do t'i jepet përafrimit të ligjislacionit nacional me Acquis comunitare.

Klasifikimi SMART i objektivit të përgjithshëm përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

| SMART | Përshkrimi |
|---|---|
| **Specifika** | Objektivi i përgjithshëm është avancimi i politikave të zhvillimit të peshkatarisë dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së me qëllim të sigurimit të një niveli të vlerësimit të stoqeve të peshkimit dhe menaxhimin e tyre; |
| **Të matshme** | Miratimi i Ligjit të ri nga Kuvendi dhe publikimi i tij në Gazetën Zyrtare të RKS-së, bazuar në Rregulloren e BE - Nr .1380/2013); |
| **E arritshme** | Objektivi i përgjithshëm pritet të arrihet përmes asistencës së Projektit "Mbështetje për përafrimin e politikës së peshkatarisë dhe akuakulturë dhe legjislacionit me Acu comunitare me Politikat e Përbashkëta të BE-së për peshkim sipas Rregullores mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (BE) Nr. 1380/2013); |
| **Relevante** | Rëndësia e masave për shfrytëzimi të qëndrueshëm të peshkimit dhe stoqeve të peshkut, menaxhimi e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara (Rregullorja (KE) Nr. 1967/2006 dhe masa specifike për stokun dhe peshkimin nën kompetencën e Peshkimit Rajonal, Rregullorja (KE) Nr. 1967/2006 (Rregullorja e Mesdheut); |
| **I kufizuar në kohë** | Arritja e objektivit të përgjithshëm lidhet me miratimin e kornizës kombëtare për transpozimin e Rregulloreve të BE-së. Afati kohor përcaktohet nga procesi / koha e nevojshme për finalizimin e koncept dokumentit si dhe koha e nevojshme për hartimin, diskutimin, finalizimin dhe miratimin e ligjit të ri bazuar në Rregulloren (BE) Nr .1380/2013 nga institucionet përkatëse sipas |

| | |
|---|---|
| | rregullave në fuqi në RKS. Pritet që koncept-dokumenti të finalizohet deri në fund të dhjetorit 2023, ndërsa projektligji i ri do të finalizohet deri në fund të vitit 2024. |

Prandaj, qëllimet e politikave dhe objektivat strategjikë janë tashmë të parapërcaktuar në dokumentet strategjike qeveritare, ndërsa objektivat specifike janë rezultat i përcaktimit të detajuar të problemit siç përshkruhet në Kapitullin 2 të këtij dokumenti, pasi ato përcaktojnë objektivat konkrete që duhen arritur.

***Qëllimi i përgjithshëm Objektivi strategjik dhe Objektivat specifike:***

| **Qëllimi i përgjithshëm i politikës:**<br>- **Përafrimi i politikave zhvillimore të peshkatarisë dhe akuakulturës përmes përafrimit me standardet dhe legjislacioninin e BE-së** | |
|---|---|
| **Objektivi strategjik:**<br>- Avancimi i politikave zhvillimore të peshkatarisë dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së me qëllim të sigurimit të një niveli të vlerësimit të stoqeve të peshkimit dhe menaxhimin e tyre bazuar në Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (BE) Nr. 1380/2013)<br><br>**Objektivat specifike:**<br><br>- Integrimi i parimeve shkencore për zhvillimin e nënsektorit të peshkatarisë dhe akuakulturës, shëndetin e peshkut dhe vlerësimi i stoqeve dhe llojeve të peshkut në harmonizim me rregulloret e BE;<br>- Përcaktimi i përgjegjësive të qarta për: operatorët që merren me peshkim ekonomik, flotës për peshkim ekonomik, peshkatarët sportivë rekreativ, peshkëzimi i resurseve ujore dhe ruajtja e biodiversitetit, peshkimi hulumtues, mbarështimin e akuakulturës dhe raportimit të të dhënave dhe mirëmbajtjen | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025<br>2.10. Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural<br>2.10.5 Siguria e ushqimit<br>- Plani Kombëtar për Zhvillim<br>Qëllimi zhvillimor dhe qëllimi strategjik:<br>-1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë<br>- Masa Strategjike: Përmbushja e kërkesave për ushqimin të sigurtë dhe të shëndetshëm<br>- Aktiviteti: Hartimi i Koncept Dokumentit për Peshkatari dhe Akuakulturë<br>-Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030<br>Shtylla e I – Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik:<br>-Qëllimi Zhvillimor: Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese:<br>Qëllimi Strategjik: 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme mes fermerëve, përpunuesve e shitësve me pakicë. |

<table>
<tr><td>e tyre për sasinë dhe llojet e peshkut në resurset ujore;<br>- Përgjegjësitë e operatorëve mbarështues të peshkut ose operatorëve që kapin / grumbullojnë peshkun për qëllime ekonomike në mënyrë që autoritetet kompetente të kenë bazë e të dhënave të përditësuar të ndërmarrjeve, aktiviteteve të tyre për sasinë e kapur/prodhuar dhe shtimin vjetor të peshkut;<br>- Përafrimi i politikave përmes harmonizimit të legjislacionit për peshkim ilegal, të pa raportuar dhe të pa rregulluar;<br>- Sistemi për njoftimin dhe raportimin e sasisë së peshkut të kapur dhe prodhuar sipas standardeve të BE dhe<br>- Baza ligjore për masat parandaluese dhe raportuese për mjetet dhe pajisjet për kapjen e peshkut dhe për mjetet dhe pajisjet e ndaluara për kapjen e peshkut.</td><td>-PKZMSA për vitet 2021-2025 përcakton një kornizë gjithëpërfshirës afatmesëm të të gjitha reformave të kërkuara për të përmbushur detyrimet që dalin nga MSA, përkatësisht masat dhe prioritetet e kërkuara për përafrimin gradual të legjislacionit kombëtar me Acquis të BE-së, duke e transpozuar këtë të fundit në legjislacionin kombëtar dhe zbatimin e legjislacionit të përafërt.<br>-Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 - 2025 është dokumenti bazë përmes të cilit Qeveria ua komunikon vizionin qytetarëve të Republikës së Kosovës në lidhje me qeverisjen e saj. Sipas Programit Qeveritar 2021-2021 objektivi është avancimi i politikave dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së, hartimit të kornizës ligjore për me qëllim të sigurimit të një niveli të vlerësimit të stoqeve të peshkimit dhe menaxhimin e tyre përafrimit me Politikat e Përbashkëta të BE-së për peshkim sipas Rregullores mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit Nr. 1380/2013.</td></tr>
<tr><td><u>Objektivat specifike Opsioni 2:</u><br>• <u>Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit;</u><br>• <u>Vlerësimi i stoqeve / resurseve peshkore;</u><br>• <u>Ngritja e vetëdijes për parandalimin e peshkimit në fazat e riprodhimit të peshkut.</u></td><td><u>Të hartuara për nevojat e këtij KD</u></td></tr>
<tr><td><u>Objektivat specifike Opsioni 3:</u><br>• <u>Avancimi i kornizës legjislative dhe rregullative;</u></td><td><u>Të hartuara për nevojat e këtij KD</u></td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| • Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit;<br>• Mbrojtja e resurseve ujore. | |

*Praktikat e vendeve tjera lidhur me Peshkatarinë në ujërat e ëmbël*

Shtetet e regjionit dhe ato të BE-së bashkëpunojnë intenzivisht në të gjitha fazat e proceseve integruese duke përafruar legjislacionin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve përmes bashkëpunimit në nivel bilateral mes shteteve të regjionit, BE-së dhe institucioneve relevante profesionale për peshkatari. Në të gjitha rastet, praktikat e vendeve të rajonit, pa marrë parasyshë proceset integruese në BE, kanë zbatuar direktivat dhe rregulloret e BE-së për peshkatari. Republika e Kroacisë si shtet anëtarë i BE-së për legjislacionin nacional ka bërë të zbatueshme të gjitha rregulloret e BE-ë, disa prej tyre madje janë obligative të zbatohen me nene të veqanta pa pasur nevojë që të jenë pjesë e legjislacionit nacional. Republika e Bosnës dhe Hercegovinës, potencialisht kandidat për anëtarsim, legjislacionin nacional për peshkatari në ujëra të ëmbël e ka të përafruar ndërsa për disa çështje as të përafruar, siç është rasti i Palnave për vlerësimin e stoqeve, peshkimi ilegal i pa raportuar dhe i pa regjistruar dhe ruajtja e biodiversiteteit dhe specieve të rrezikuara.

***Shembulli i Republikes së Kroacisë***

ZAKON O SLATKOVODNOM RIBARSTVU NN 63/19, i cili ka hyrë në fuqi 06.07.2019.

**Peshkimi ekonomik:**

Republika e Kroacisë me legjislacion të veqant, bazuar në rregulloret e BE-së, ka rregulluar peshkimin në ujërat e ëmbël, Ligji për peshkim në ujëra të ëmbël. Ligji rregullon menaxhimin racional dhe të qëndrueshëm të stokut të peshkut të ujërave të peshkimit të brendshëm, ujërat e peshkimit, bazuar në njohuritë shkencore dhe profesionale në fushën e iktiologjisë dhe ekologjisë së ujërave të brendshme, organet kompetente dhe përgjegjësitë e tyre, mënyrën dhe kushtet për ushtrimin e të drejtës së peshkimit, monitorimi i kapjeve nëpërmjet gjurmueshmërisë së tij në treg në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të Bashkimit Evropian në pjesën e tregut të produkteve të peshkimit, mbledhjen e të dhënave, mbikëqyrjen dhe inspektimin, dispozitat kundërvajtëse, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për peshkimi i ujërave të ëmbla. Ligj zbatohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë peshkim sportiv, ekonomik, shkencor dhe edukativ për nevojat e akuariumeve të hapura për publikun dhe peshkimin selektiv në ujërat e peshkimit të Republikës së Kroacisë. Gjithashtu me këtë ligj janë rregulluar edhe tregu i produkteve të peshkimit dhe mbledhjes së të dhënave për

personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në peshkimin komercial dhe nxjerrin në treg produktet e peshkut.

Ligji sipas përvojës së Republikës së Kroacisë ka determinuar shumë qartë ujërat për peshkim, klasifikimin e tyre dhe mënyrën e ekonomizimit të tyre për peshkim ekonomik dhe për peshkim sportiv. Institucionet hartojnë Program për përcjelljen e gjendjes së stokut të peshkut gjatë gjithë vitit kalendarik për hartimin e programit, institucionet përdorin si bazë rezultatet e kërkimeve të marra gjatë zbatimit të programit të monitorimit të stokut të peshkut gjatë krijimit të planeve të menaxhimit, rishikimeve dhe shtesave në planet e menaxhimit.

**Puna kërkimore shkencore dhe peshkimi sportivë:**

Sipas praktikave Evropiane, me kapitull të veqantë të ligjit është rregullar mandati i institucioneve kërkimore shkencore në peshkatari, sipas ligjit këto institucione janë autoritet publik dhe mund të kryejnë shërbimet si në vijim: Hartojnë plane menaxhimi për zonat e peshkimit, përgatit studime dhe vlerësime shkencore e profesionale për gjendjen e stokut të peshkut dhe propozon masa për mbrojtjen e peshqve, të kryejë kërkime në fushën e kushteve veterinare dhe sanitare të stokut të peshkut, japin mendime shkencore dhe profesionale për Ministrinë., të dhënat shkencore bëhen publike në ueb faqen e Ministrisë. Ndërsa me peshkim sportivë mund të merren vetëm personat që kanë dhënë provimin e peshkimit, kanë leje peshkimi dhe përdorni teknikat e lejuara të peshkimit.

**Peshkëzimi:**

Sipas praktikës kroate, bartësi i së drejtës së peshkimit është i obliguar ta zhvendosë peshkun në zonën e peshkimit për të cilën ka marrë të drejtën e peshkimit sipas planit të menaxhimit në rast të ndryshimit të vetive fizike, kimike ose biologjike të ujit të peshkimit dhe transferimi i peshkut parashikohet në planin e menaxhimit. Transferimin e fondit të peshkut e kryen titullari i së drejtës së peshkimit, por edhe titullari i cili shfrytëzonë resurset për peshkim komercial.

**Tregëtimi dhe të dhënat statistikore**

Me ligj mund të vihen në treg vetëm produktet e peshkimit nga peshkimi komercial ndalohet vendosja në treg e produkteve të peshkimit nën përmasat minimale të lejuara ndërsa lidhur me sigurinë e shëndetit të konsumatorit, produktet e peshkimit duhet të jenë të gjurmueshme në të gjitha fazat. Programin për përcjelljen e gjendjes së stokut të peshkut dhe raportimin e të dhënave e përcakton ministri.

**Ndalesat dhe inspektimi:**

Me ligj ndalohet kapja e peshkut në ujërat e peshkimit duke përdorur specie të huaja dhe pushtuese peshqish (të gjallë ose të vdekur) si karrem, kapja e peshkut drejtpërsëdrejt me

dorë, duke e tërhequr dhe fiksuar nga jashtë trupit të peshkut etj. Ndërsa për zbatimin e dispozitave ligjore janë të mandatuar: inspektorët e peshkimit, nëpunësit civilë të autorizuar të Ministrisë të autorizuar nga ministritë: Bujqësisë, punëve të brendëshme, financave, transportit , menaxhimin e ujërave dhe drejtorisë doganore.

***<u>Shembulli i Republikës së Malit të Zi</u>***

ZAKONA O SLATKOVODNOM RIBARSTVU I AKVAKULTURI Broj: 01-290/2 Podgoricë, i cili ka hyrë në fuqi 16. Mars 2018.

**<u>Peshkimi ekonomik</u>**

Republika e Malit të Zi me legjislacion të veqantë, të përafruar me rregulloret e BE-së, ka rregulluar peshkimin në ujërat e ëmbël, Ligji për peshkim në ujëra të ëmbël, në origjinal: ZAKONA O SLATKOVODNOM RIBARSTVU I AKVAKULTURI Broj: 01-290/2 Podgoricë, 16. Mars 2018. godine, ky ligj rregullon peshkimin e ujërave të ëmbla jo vetëm të peshkut por edhe specieve tjera akuatike, peshkimin, akuakulturën, mbrojtjen e peshkut dhe kulturave akuatike, shërbimin e rojeve të peshkimit, mbikëqyrjen administrative dhe inspektuese mbi zbatimin e ligjit, dispozitat penale dhe çështje të tjera të rëndësishme për fushën e peshkimit në ujërat e ëmbla në territorin e Malit të Zi.

Sipas këtij ligji, resurset e peshkut dhe akuatike përdoren në mënyrë të qëndrueshme në ruajtjen e diversitetit biologjik të sistemeve ekologjike. Zonat e peshkimit caktohen nga ministria duke i dhënë të drejtën e peshkimit me tender, me kompensim dhe në bazë të programit të paraqitur për menaxhimin e zonës së peshkimit. Shuma e kompensimit përcaktohet nga qeveria. Përdoruesi është i detyruar të zbatojë programin e paraqitur për menaxhimin e zonës së peshkimit. Programi vjetor duhet të përmbajë: Vlerësimi i stoqeve të peshkut, sasinë e lejuar vjetore të peshkut të kapur sipas llojeve, masat dhe mënyra e mbrojtjes së zonës së peshkimit, organizimi i punës së shërbimit të rojës së peshkut dhe plani i punës për rregullimin e rrethinës, fondet e planifikuara dhe qëllimi i përdorimit të tyre. Pëlqimi për Programet vjetore, lëshohet nga ministria për bujqësi.

Për ushtrimin e të drejtës ekonomike për akuakulturë aplikuesi /operatori duhet të jetë: shoqëri tregtare ose personit juridik të cilit i është lëshuar licenca për akuakulturë duhet të dokumentojë sipërfaqen e pellgut, zonën ujore që do të përdoret për akuakulturë dhe llojet e peshkut ose organizmave të tjerë ujorë që do të kultivohen. Kërkesa për marrjen e licencës për akuakulturë paraqitet në përputhje me Ligjin për Koncesionet.

Përpos peshkimit ekonomik dhe akuakulturës, me këtë ligj, është i rregulluar edhe peshkimi sportiv, është i rregulluar ashtu që peshkatarët duhet të organizohen në shoqata dhe janë të obliguar që të zbatojnë masa për promovimin dhe mbrojtjen e fondit të peshkut, organizon pjesëmarrjen në aktivitete mjedisore në fushën e veprimtarisë së saj dhe mban evidencë për provimet e mbartura të peshkimit sipas Programit të Provimeve të Kalimit të Peshkimit. Shoqatat gjithashtu organizojnë shpërndarjen e licencave për

peshkim sportiv dhe sipas programit vjetor të garave organizon, zhvillon dhe jep miratimin për të gjitha garat sportive. Shoqatat organizojnë roje peshkimi dhe të njëjtit duhet të jenë të pajisur me karta identifikimi.

**Peshkimi për qëllime kërkimore-shkencore**

Peshkimi për qëllime kërkimore-shkencore në ujërat e peshkimit mund të kryhet në bazë të lejes së lëshuar nga ministria, në bazë të kërkesës dhe programit të paraqitur. Leja për peshkim për qëllime kërkimore shkencore duhet të tregojë: Në cilat ujëra peshkohet për qëllime kërkimore shkencore, në cilat raste, në çfarë kohe, lloji dhe sasia e peshkut, gjithashtu edhe mënyra e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve për peshkim.
Mbajtësi i licencës është i detyruar të informojë ministrinë dhe përdoruesin për kohën në të cilën do të peshkojnë për qëllime kërkimore shkencore.

**Ndalesat dhe inspektimi**

Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të tij e kryejnë inspektimi i bujqësisë ndërsa sigurinë e shëndetit të peshkut, kontrollin veterinar-shëndetësor, e kryen inspektimi veterinar.

***Shembulli i Republikës së Shqipërisë.***

LIGJ Nr. 64/2012 PËR PESHKIMIN, Miratuar në datën 31.5.2012, shpallur me dekretin Nr. 7544, datë 15.6.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

**Peshkimi ekonomik**

Republika e Shqipërisë me legjislacion, të përafruar me rregulloret e BE-së, ka rregulluar veprimtarinë e peshkimit në tërësi, menaxhimin e tij, mbrojtjen e gjallesave detare dhe të ujërave të brendshme, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm në aktivitetin në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë. Ky ligj nuk rregullon marrëdhëniet që lindin dhe lidhen me sigurinë ushqimore të produkteve të peshkimit, mbrojtjen e konsumatorit dhe sëmundjet e peshqve, të cilat rregullohen me ligje të veçanta. Ky ligj ka për qëllim: Sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe atyre detare, përcaktimin e rregullave për menaxhimin dhe bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit nëpërmjet përfshirjes së komuniteteve përkatëse në proceset e vendimmarrjes, përcaktimin e masave të ruajtjes, që garantojnë mbrojtjen e burimeve biologjike detare dhe ujërave të brendshme, nxitjen dhe përkrahjen e kërkimit shkencor e teknologjik dhe grumbullimit të të dhënave në peshkim, sigurimin e funksionimit dhe menaxhimit të porteve e të qendrave të peshkimit, hartimin dhe sigurimin e një politike strukturore, me qëllim ristrukturimin e sektorit të peshkimit, sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, forcimin e konkurrencës e zhvillimit ekonomikisht të vlefshëm

të subjekteve të peshkimit, rigjallërimin e zonave që varen nga peshkimi, si dhe përmirësimin e furnizimit të tregut dhe rritjen e vlerës së prodhimit, përcaktimin e masave dhe rregullave të nevojshme për kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e politikave të peshkimit, në përputhje të plotë me politikat europiane në këtë drejtim, ngritjen e një sistem kontrolli për peshkimin dhe vendosjen e procedurave të inspektimit të standardizuara dhe të koordinuara si në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut. Marrë parasyshë resurset detare dhe flotën e peshkimit, të cilat i ka në dispozicion, janë rregulluar edhe masat për përshtatjen e flotës së peshkimit duke përfshirë në planet e përshtatjes së kapaciteteve të peshkimit dhe disponibilitetit të burimeve. Gjithashtu ka rregulluar edhe kontrollin e kushteve të hyrjes në ujërat dhe burimet ujore, promovimin e organizimit të zinxhirit të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të prodhimeve peshkore.

Me qëllim të përafrimit të politikave nacionale me ato të BE-së. Me legjislacion ka rregulluar: Masat për ujërat e brendshme dhe përpunimin e tregtimin e prodhimeve peshkore, mbështetja për peshkimin në ujërat e brendshme për ndërtimin, zgjerimin fuqizimin dhe modernizimin e mjeteve të peshkimit, me qëllim përmirësimin e sigurisë në bord, të kushteve të punës, higjienës, cilësisë së prodhimit, si dhe reduktimin e impaktit negativ mbi mjedisin, mbështetja për peshkatarët dhe pronarët e mjeteve lundruese të peshkimit, në kuadër të masave për mbrojtjen e llojeve të veçanta të peshkut dhe organizmave të tjerë të ujërave të brendshme, në ndalimin e përkohshëm të aktivitetit të peshkimit. Përpos për ujërat detare dhe akuakulturë ka rregulluar edhe ujrat e brendshëm: masat për ujërat e brendshme dhe përpunimin e tregtimin e prodhimeve peshkore janë si më poshtë, mbështetja për peshkimin në ujërat e brendshme për ndërtimin, zgjerimin fuqizimin dhe mbështetja për peshkatarët dhe pronarët e mjeteve lundruese të peshkimit, në kuadër të masave për mbrojtjen e llojeve të veçanta të peshkut dhe organizmave të tjerë të ujërave të brendshme, në ndalimin e përkohshëm të aktivitetit të peshkimit dhe promovimi i cilësive mjedisore të mjedisit detar. Programi kombëtar shumëvjeçar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave biologjike, teknike, mjedisore dhe social - ekonomike përfshinë të dhënat për: Peshkimin tregtar, të kryer nga anijet e peshkimit, përfshirë edhe peshkimin e ngjalës, peshkimin çlodhës – argëtues, industrinë e përpunimit të prodhimeve peshkore etj. Regjistrimi i sasive me produkte peshkimi të gjithat sasitë me produkte peshkimi duhet të regjistrohen në të gjitha stadet e prodhimit, përpunimit apo shpërndarjes, që nga zënia deri te vendosja në treg për shitje me pakicë.

Peshkimi i paligjshëm, i parregulluar dhe i paraportuar rezulton në rastet kur mjeti lundrues: a) Ka peshkuar pa leje apo pa autorizim të vlefshëm; b) Nuk ka respektuar detyrimet e lidhura me regjistrimin dhe c) Deklarimin e të dhënave për zëniet ose të të

dhënave të lidhura me to, përfshirë këtu dhe të dhënat që transmetohen nëpërmjet satelitit ose lajmërimit paraprak.
Strategjia kombëtare e peshkimit përcakton gjithashtu përparësitë, qëllimet, fondet e nevojshme, si dhe afatet e parashikuara për: Sigurimin e pajisjeve dhe kushteve të tjera për kryerjen e inspektimeve/kontrolleve të aktivitetit të peshkimit, si dhe mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve që janë të rëndësishme për politikat e përbashkëta të peshkimit, mbështetjen dhe asistencën teknike për nismat që forcojnë qëndrueshmërinë e sektorit, peshkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të peshkimit jashtë detit territorial, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare. Strategjia kombëtare e peshkimit përgatitet prej ministrisë në bashkëpunim dhe bashkërendim me: a) Autoritetet kompetente kombëtare publike, qendrore dhe vendore; b) Institucionet shkencore, institucionet dhe/ose organet e tjera ekspertë në fushën e peshkimit dhe mjedisit dhe c) Grupet e interesit në fushën e peshkimit dhe mjedisit.
Bazuar në strategji, me legjislacion është rregulluar edhe Plani i menaxhimit të peshkimit, i cili përmban objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm të zhvillimit të peshkimit, llojet e masave dhe të programeve, rezultatet e pritshme, si dhe burimet e nevojshme të fondeve për financimin e masave të politikave të peshkimit.

**<u>Peshkimi për qëllime kërkimore-shkencore</u>**

Peshkimi për qëllime kërkimore-shkencore në ujërat e peshkimit mund të kryhet në bazë të lejes së lëshuar nga ministria. Me nen të veqantë ka përcakltuar llojet e peshqve objekt peshkimi që peshkohen/zihen në det dhe në ujërat e brendshme, si dhe zonat respektive të peshkimit, me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin ujor. Rregullorja përmban edhe: a) Emrin shqip dhe shkencor të llojeve të peshkut; b) Koordinatat gjeografike të zonës së peshkimit dhe c) Të dhëna të tjera, të cilat janë të rëndësishme për menaxhimin e llojeve të peshkut në përputhje me këtë ligj.

**<u>Peshkimi çlodhës - argëtues</u>**

Peshkimi çlodhës - argëtues konsiston në zënien/mbledhjen e një sasie peshku dhe organizmash të tjerë ujorë, nëpërmjet përdorimit të veglave dhe pajisjeve të lejuara për peshkimin çlodhës - argëtues dhe që nuk ka për qëllim final shitjen/shkëmbimin apo tregtimin e peshkut. Ky lloj peshkimi sipas përvojës së Shqipërisë në asnjë rast dhe për asnjë arsye, ushtrimi i peshkimit çlodhës - argëtues nuk duhet të
ndërhyjë, të pengojë, të rrezikojë apo të vështirësojë peshkimin tregtar.

**<u>Ndalesat dhe inspektimi</u>**
Sipas përvojës së republikës së Shqipërisë për zbatimin e legjislacionit organ kompetent është Autoriteti i inspektimit të peshkimit dhe është pjesë e strukturës së ministrisë. Inspektorët kryejnë inspektimin mbi baza jodiskriminuese, në det, në porte, gjatë transportit, gjatë procesit të përpunimit dhe në tregun e shitjes së peshkut dhe të nënprodukteve të tij. Ministri përcakton rregullat përkatëse për kompetencat e inspektorëve për inspektimin e peshkimit, si pjesë përbërëse e inspektoratit shtetëror kompetent. Inspektorët për peshkimin, për shkelje të dispozitave të këtij ligji kanë të drejtë: a) Të ndalojnë shkelësin dhe mjetin lundrues, në të cilin është konstatuar shkelja, të kërkojnë gjenealitetet e shkelësit, të përpilojnë formularin e procesverbalit të konstatimit të shkeljes, të ndalojnë e të shoqërojnë menjëherë në komisariatin apo rajonin më të afërt të policisë si dhe në rastet kur shkelja përbën vepër penale, të bëjnë kallëzim në organet gjyqësore dhe të sekuestrojnë sendet e përdorura për kryerjen e shkeljes ose që janë pasojë e shkeljes.

**<u>Mangësitë e identifikuara në sektorin e peshkatarisë mund të adresohen me tre opsione të ndryshme:</u>**

**Kapitulli 3: Opsionet**

**<u>3.1: Opsioni asnjë ndryshim</u>**

Opsioni i parë do të mbështes situatën aktuale dhe rregullat për peshkatari do të mbeten të njëjta. Nëse ndryshimet nuk ndodhin, korniza ligjore e Kosovës për peshkatari do të mbetej pa një kornizë horizontale që përcakton objektivat e përgjithshme strategjike për peshkatari dhe e pamjaftueshme për zbatimin e masave për peshkatari siç kërkohet nga legjislacioni i BE-së. Rregullat do të vazhdojnë të janë të pakompletuara: Për menaxhimin e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara ( rasti i ngjala evropiane), për standardet e raportimit të të dhënave dhe përditësimit të tyre për stoqet e peshkut dhe akuakulturës, për standardet e raportimit të të dhënave dhe përditësimi të tyre për kapacitetin specifik të flotës së peshkimit dhe nuk do të ketë të rregulluar sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar.

Mangësitë në kornizën aktuale ligjore për peshkatarinë dhe akuakulturën janë edhe fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike të resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet, nuk ka të rregulluar sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar dhe nuk ka bazën ligjore për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e resurseve peshkore.

Një qasje e vjetër e bazuar në kontrollin reaktiv, pa mbështetje shkencore dhe bazë ligjore adekuate për të zhvilluar sektorin do të vazhdonte të zbatohet, ashtu që programet e kërkuara të

vlerësimit të stoqeve nuk mund të zbatoheshin ligjërisht në zhvillim drejt kontributit në thithjen e fondeve për zhvillimin e sektorit dhe avancimi i politikave të peshkatarisë dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së me qëllim të sigurimit të një niveli të vlerësimit të stoqeve të peshkimit dhe menaxhimin e tyre bazuar në Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (BE) Nr. 1380/2013).

Sektori do të vazhdoj të mbetet pa investime dhe ekonomizim, ndërsa mjetet ekzistuese rregullative do të përdoren për të trajtuar problemet e identifikuara, gjë që në terma afatgjatë, do të mbajë në të njëjtin nivel, me mundësi degradimi të sektorit. Për më tepër, mungesa e boshllëqeve të identifikuara në legjislacionin aktual do të paraqiste ngarkesë për institucionet dhe palët me interes nga peshkataria sidomos në zhvillimin e politikave, zbatimin e legjislacionit dhe përafrimin e tyre me PPB të BE-së në peshkatari për mënyrën e mbështetjes financiare për zbatimin e politikave të peshkimit, masat përkatëse në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës. Gjithashtu nuk mundëson arritjen e kapaciteteve / praktikave të shtetetve anëtare të BE-së për kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për zbatim efikas të PO, rregulla për organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës, tregut për peshkun dhe prodhimet akuatike. Sa i përket ofrimit të shërbimeve, ky opsion nuk do të ofrojë ndryshime as në kornizën ligjore, por as në atë operacionale për përmirësimin e tyre. Barra administrative do të mbetet e njejtë për përdoruesit.

## 3.2. Përmirësimi i kornizës ligjore aktuale

Opsioni i dytë do të mundësonte përmirësimin e Ligjit aktual për peshkatari dhe akuakulturë. Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 10 Tetor 2006 përmban dispozita themelore për peshkatari dhe akuakulturë. Me këtë ligj janë rregulluar peshkimin ekonomik, zonat e peshkimit, peshkimin hulumtues për qëllime kërkimore – shkencore, peshkimin sportiv-rekreativ, pajisjet për peshkim, licencimin e akuakulturës, mbrojtjen e peshkut në periudhën e riprodhimit peshkimin hulumtues, peshkëzimin dhe mekanizmat e zbatimit dhe masat ndëshkimore për zbatimin e legjislacionit në peshkatari dhe akuakulturë.

Meqenëse rregullat e BE-së për peshkatari janë komplekse dhe gjithëpërfshirëse ndërhyrjet, në legjislacionin aktual, mund të fokusohen vetëm në mënyrën e mbështetjes financiare për zbatimin e politikave të peshkimit, masat përkatëse në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës mund të plotësohet, sipas praktikave të shtetetve anëtare të BE-së, me kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për zbatim efikas të PO dhe rregulla për organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe tregut për peshkun dhe prodhimet akuatike. Të shtohen edhe elementet e ofrimit të shërbimeve, duke reflektuar definimin e problemit.

Ky opsion do të nënkuptonte miratimin e versionit të përmirësuar të Ligjit për peshkatarinë, ndërsa pjesët që mungojnë do të plotësohen me legjislacionin dytësor që do të fokusohej në

kërkesat më specifike dhe më të detajuara zbatuese për rregullat për mbështetjen financiare për zbatimin e politikave të peshkimit në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës, kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësin e çasjes në fondat e EMFF të BE-së, për standardet e raportimit të të dhënave dhe përditësimi të tyre për stoqet e peshkur dhe akuakulturës, menaxhimi i rezervave për speciet e veqanta dhe fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet e veqanta. Ky opsion ofron mundësinë e kompletimit të kornizës ligjore për ofrimin e shërbimeve në këtë fushë, duke kompletuar legjislacionin sekondar për shërbimet e mbetura. Megjithatë, për shkak të intervenimit të kufizuar, prapë se prapë nuk do të mund të ofrohej harmonizim me kërkesat e LPPA, gjë që do të rezultonte në intervenime të kufizuara operacionale për zvogëlim të barrës administrative.

## 3.3. Miratimi i kuadrit të ri ligjor për peshkatari dhe akuakulturë

Për shkak të kompleksitetit dhe gjithë përfshirjes së zonës, opsioni i tretë do të mbështeste përgatitjen e Ligjit të veçantë kombëtar për peshkatari.

Sipas këtij opsioni, korniza e re ligjore do të përcaktonte parimet dhe objektivat për politikën e zhvillimit të peshkatarisë, kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësin e çasjes në fondat e EMFF të BE-së, menaxhimi specifik për masat e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit dhe stoqeve të peshkut, menaxhimi e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara, siç është rasti i ngjala evropiane, ruajtjen biologjike resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet e gjithë kjo për të arritur rezultatet e dëshiruara dhe qasje gjithëpërfshirëse horizontale. Rezultatet, të tilla si çasjes në fondat e EMFF të BE-së, masat e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit dhe stoqeve të peshkut, menaxhimi e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara, ruajtjen biologjike resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet, do të harmonizohen me standardet ndërkombëtare, BE-së.

Ligji i ri për peshkatarinë do të përfshijë elementet themelore si në vijim:

- Ruajtjen biologjike resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet;

- Përkufizime / shprehjet e përdorura për të kuptuar parimet e BE-së për peshkatari dhe akuakulturë për transpozimin dhe zbatimin e mëtejshëm të kornizës ligjore të BE-së;

- Menaxhimi specifik për masat e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit dhe stoqeve të peshkut;

- Rregulla për menaxhimi e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara;

- Standardet për të dhënat dhe përditësimi i të dhënave për kapacitetin specifik-teknik të flotës së për peshkimit;

- Rregullat për mbështetjen financiare për zbatimin e politikave të peshkimit në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës;

-Kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësin e çasjes në fondat e EMFF të BE-së u;

- Kërkesat ligjore për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës, duke përfshirë miratimin e planit strategjike kombëtare shumëvjeçare për sektorin;

- Bazën ligjore, sipas praktikave të shtetetve anëtare të BE-së për kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për zbatim efikas të OP;

- Rregulla për organizatat profesionale;

- Rregulla për standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe tregut për peshkun dhe prodhimet akuatike;

- Rregullat për sistemin/mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar;

- Rregullat për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e resurseve peshkore.

Sa i takon barrës administrative, përmes këtij opsioni do të sigurohej harmonizim i plotë në mes kornizës ligjore për peshkatari dhe akuakulturë me kërkesat e LPPA, sidomos sa i përket proporcionalitetit në procedurë, respektimit të parimit të mos-pagesës, afateve të ofrimit të shërbimit, si dhe rregullimit të procedurave të ankimimit.

Në aspekt operacional, në fazën afat shkurtër do të mundësohej thjeshtim i procedurës së shërbimit, duke shkurtuar kohën e ofrimit dhe duke ulur koston në pajtim me kërkesat e LPPA.

Në fazën afat mesme do të procedohet me digjitalizimin e plotë të shërbimeve, ku e gjithë procedura, përfshirë dorëzimin, shqyrtimin, pagesat dhe lëshimin e lejeve dhe licencave bëhet përmes sistemit elektronik të menaxhuar nga MBPZHR.

Kjo do të përmirësojë procesin e përafrimit me kërkesat e BE-së për peshkimin dhe akuakulturën. Ligji i ri të peshkimit dhe akuakulturës duhet të përfshijë rregulloret për Politikat e Përbashkëta të Peshkimit (CFP) dhe të Fondit Europian të Detarisë dhe Peshkimit (EMFF), (Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr 1380/2013). Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 përcakton dispozitat për Evropianin Fondi i Peshkimit Detar (EMFF) për mbështetjen financiare për zbatimin e Përbashkët Politika e Peshkimit, masat përkatëse në lidhje me Ligjin e Detit, zhvillimin e qëndrueshëm të zonat e peshkimit dhe akuakulturës dhe peshkimi në brendësi si dhe për masat në kuadër të Integruar Politika Detare. Për të përfituar nga EMFF, shteteve anëtare të BE-së u kërkohet të miratojnë a dokument strategjik dhe një program operativ (PO).

CFP parashikon rregulla për ruajtjen biologjike detare, burimet, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet, gjithashtu, përfshinë organizimin e tregut të përbashkët për peshkimin dhe produktet e akuakulturës, një politikë strukturore me fond të dedikuar kontrollin e aktivitetit të peshkimit dhe mbi zbatimin.

CFP promovon masa të bazuara në këshilla të shëndosha shkencore dhe ofron a kornizën për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave të peshkimit. Menaxhimi specifik masat për shfrytëzimin e qëndrueshëm të peshkimit janë përcaktuar në Rregullorja (KE) Nr. 1967/2006, ndërkohë janë përcaktuar masa specifike për stokun dhe peshkimin nën kompetencën e Peshkimit Rajonal përkatës Organizata e Menaxhimit, veçanërisht GFCM17 dhe ICCAT18.

Rregulla specifike me ligjin e ri duhet të zbatohen gjithashtu për menaxhimin e rezervave, siç është ngjala evropiane (Rregullorja 1100/2007). Në lidhje me Menaxhimin e burimeve dhe flotës, acquis përmban rregulla specifike për rregullimin e peshkimit kapacitet për të kërkuar një ekuilibër midis flotës dhe stoqeve si dhe për matjen e fuqisë së motorrit dhe tonazhi i anijes.

Bazuar në praktikat e BE-së kërkohet të mbledhin dhe përditësojnë të dhënat që lidhen me të për kapacitetin e peshkimit në një regjistër specifik të flotës së peshkimit sipas Rregullores së Komisionit (KE) 26/2004. Inspektimi dhe kontrolli janë kryesisht përgjegjësi e shteteve anëtare që kanë nevojë për të siguruar kapacitetin administrativ për zbatim efektiv, në përputhje me ligjin e BE-së kuadri i vendosur nga Rregullorja e Këshillit (KE) 1224/2009, e cila vendos ndër të tjera rregulla të hollësishme për regjistrimin, raportimin e kapjeve funksionimin dhe monitorimit të anijeve.

Sipas praktikave të shteteve anëtare të BE-së duhet të kenë gjithashtu kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për të siguruar një të shëndoshë dhe zbatimi efikas i OP.

Acquis e politikës së tregut përcaktohet nga Rregullorja (BE) 1379/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe parashikon rregulla profesionale për organizatat, standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe tregu inteligjencës. Përveç rregullave të përgjithshme të ndihmës shtetërore, acquis përmban rregulla specifike të ndihmës shtetërore të zbatueshme për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës. Duke pasur parasysh kompetencën e saj ekskluzive në fushën e ruajtjes së burimeve biologjike detare, BE-ja është palë e një numri ndërkombëtar marrëveshjet dhe organizatat. Marrëveshjet dhe konventat

dypalëshe të peshkimit me të tretën vendet ose organizatat ndërkombëtare duhet të përshtaten ose denoncohen përpara anëtarësimit.

CFP përfshinë rregulla që synojnë të sigurojnë gjurmueshmërinë, sigurinë dhe cilësinë e produkteve gjithashtu, CFP kontribuon në rritjen e produktivitetit për sektorin e peshkimit, qëndrueshmëri të furnizimeve dhe me çmime të arsyeshme.

Acquis përbëhet nga një sërë rregulloresh, të cilat nuk kanë nevojë për transpozim në legjislacionin kombëtar, por që kërkojnë futjen e masave për të lejuar administrata dhe operatorët për të zbatuar saktë Politikën e Përbashkët të Peshkimit (CFP) rregullat.

**Praktikat e vendeve të rajonit, të cilat mund të gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës dhe të cilat do të mirren parasysh gjatë hartimit të Ligjit të ri janë:**

**Shembulli i Republikës së Kroacisë**

***<u>Shembulli i Republikës së Kroacisë</u>***
ZAKON O SLATKOVODNOM RIBARSTVU NN 63/19, i cili, ka hyrë në fuqi 06.07.2019.
**<u>Peshkimi ekonomik:</u>**
Republika e Kroacisë me legjislacion të veqantë, bazuar në rregulloret e BE-së, ka rregulluar peshkimin në ujërat e ëmbël, Ligji për peshkim në ujëra të ëmbël. Ligji rregullon menaxhimin racional dhe të qëndrueshëm të stokut të peshkut të ujërave të peshkimit të brendshëm, ujërat e peshkimit, bazuar në njohuritë shkencore dhe profesionale në fushën e iktiologjisë dhe ekologjisë së ujërave të brendshme, organet kompetente dhe përgjegjësitë e tyre, mënyrën dhe kushtet për ushtrimin e të drejtës së peshkimit, monitorimi i kapjeve nëpërmjet gjurmueshmërisë së tij në treg në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të Bashkimit Evropian në pjesën e tregut të produkteve të peshkimit, mbledhjen e të dhënave, mbikëqyrjen dhe inspektimin, dispozitat kundërvajtëse, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për peshkim në ujëra të ëmbla. Ligji zbatohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë peshkim sportiv, ekonomik, shkencor dhe edukativ për nevojat e akuariumeve të hapura për publikun dhe peshkimin selektiv në ujërat e peshkimit të Republikës së Kroacisë. Gjithashtu me këtë ligj janë rregulluar edhe tregu i produkteve të peshkimit dhe mbledhjes së të dhënave për personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në peshkimin komercial dhe nxjerrin në treg produktet e peshkut.
Ligji sipas përvojës së Republikës së Kroacisë ka determinuar shumë qartë ujërat për peshkim, klasifikimin e tyre dhe mënyrën e ekonomizimit të tyre për peshkim ekonomik dhe për peshkim sportiv. Institucionet hartojnë Program për përcjelljen e gjendjes së stokut të peshkut gjatë gjithë vitit kalendarik për hartimin e programit, institucionet përdorin si bazë rezultatet e kërkimeve të marra gjatë zbatimit të programit të monitorimit të stokut të peshkut gjatë krijimit të planeve të menaxhimit, rishikimeve dhe shtesave në planet e menaxhimit.
Puna kërkimore shkencore dhe peshkimi sportiv:
Sipas praktikave Evropiane, me kapitull të veqantë të ligjit është rregullar mandati i institucioneve kërkimore shkencore në peshkatari, sipas ligjit këto institucione janë autoritet publik dhe mund të kryejnë shërbimet si në vijim: Hartojnë plane menaxhimi për zonat e

peshkimit, përgatit studime dhe vlerësime shkencore e profesionale për gjendjen e stokut të peshkut dhe propozon masa për mbrojtjen e peshqve, të kryejë kërkime në fushën e kushteve veterinare dhe sanitare të stokut të peshkut, japin mendime shkencore dhe profesionale për Ministrinë, të dhënat shkencore bëhen publike në ueb faqen e Ministrisë. Ndërsa me peshkim sportiv mund të merren vetëm personat që kenë dhënë provimin e peshkimit, kanë leje peshkimi dhe përdorin teknikat e lejuara të peshkimit.

**Peshkëzimi:**
Sipas praktikës kroate, bartësi i së drejtës së peshkimit është i obliguar ta zhvendosë peshkun në zonën e peshkimit për të cilën ka marrë të drejtën e peshkimit sipas planit të menaxhimit në rast të ndryshimit të vetive fizike, kimike ose biologjike të ujit të peshkimit dhe transferimi i peshkut parashikohet në planin e menaxhimit. Transferimin e fondit të peshkut e kryen titullari i së drejtës së peshkimit, por edhe titullari i cili shfrytëzonë resurset për peshkim komercial.
Tregëtimi dhe të dhënat statistikore
Me ligj mund të vihen në treg vetëm produktet e peshkimit nga peshkimi komercial ndalohet vendosja në treg e produkteve të peshkimit nën përmasat minimale të lejuara, ndërsa lidhur me sigurinë e shëndetit të konsumatorit, produktet e peshkimit duhet të jenë të gjurmueshme në të gjitha fazat. Programin për përcjelljen e gjendjes së stokut të peshkut dhe raportimin e të dhënave e përcakton ministri.
**Ndalesat dhe inspektimi:**
Me ligj ndalohet kapja e peshkut në ujërat e peshkimit duke përdorur specie të huaja dhe pushtuese peshqish (të gjallë ose të vdekur) si karrem, kapja e peshkut drejt për së drejti me dorë, duke e tërhequr dhe fiksuar nga jashtë trupit të peshkut etj., ndërsa për zbatimin e dispozitave ligjore janë të mandatuar: Inspektorët e peshkimit, nëpunësit civilë të autorizuar të Ministrisë të autorizuar nga ministritë: Bujqësisë, Punëve të brendëshme, Financave, Transportit, Menaxhimin e ujërave dhe Drejtorisë doganore.
***Shembulli i Republikës së Shqipërisë.***
LIGJ Nr. 64/2012 PËR PESHKIMIN, Miratuar në datën 31.5.2012, shpallur me dekretin Nr. 7544, datë 15.6.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
**Peshkimi i paligjshëm, i parregulluar dhe i paraportuar**
Peshkimi i paligjshëm, i parregulluar dhe i paraportuar sipas përvojës së Republikës së Shqipërisë është përvojë e mirë që mund të shfytëzhet për rregullimin kur këtij lloji të peshkimit mjeti lundrues: a) Ka peshkuar pa leje apo pa autorizim të vlefshëm; b) Nuk ka respektuar detyrimet e lidhura me regjistrimin dhe c) Deklarimin e të dhënave për zëniet ose të të dhënave të lidhura me to, përfshirë këtu dhe të dhënat që transmetohen nëpërmjet satelitit ose lajmërimit paraprak. Peshkimi për qëllime kërkimore-shkencore

**<u>Peshkimi për qëllime kërkimore-shkencore</u>**

Peshkimi për qëllime kërkimore-shkencore në ujërat e peshkimit mund të shfrytëzohet si model sepse sipas kësaj përvoje kryhet në bazë të lejes së lëshuar nga ministria. Me nen të veqantë ka përcaktuar llojet e peshqve objekt peshkimi që peshkohen/zihen në det dhe në ujërat e brendshme, si dhe zonat respektive të peshkimit, me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin ujor. Rregullorja përmban edhe: a) Emrin shqip dhe shkencor të llojeve të peshkut; b) Koordinatat gjeografike të zonës së peshkimit dhe c) Të dhëna të tjera, të cilat janë të rëndësishme për menaxhimin e llojeve të peshkut në përputhje me këtë ligj.

**<u>Peshkimi çlodhës - argëtues</u>**

Peshkimi çlodhës - argëtues po ashtu është një përvojë e re që mund të shërbejë për ndarjen që duhet bërë në mes peshkimit rekreativ dhe atij sportiv. Kjo përvojë konsiston në zënien/mbledhjen e një sasie peshku dhe organizmash të tjerë ujorë, nëpërmjet përdorimit të veglave dhe pajisjeve të lejuara për peshkimin çlodhës - argëtues dhe që nuk ka për qëllim final shitjen/shkëmbimin apo tregtimin e peshkut. Ky lloj peshkimi sipas përvojës së Shqipërisë në asnjë rast dhe për asnjë arsye, ushtrimi i peshkimit çlodhës - argëtues nuk duhet të ndërhyjë, të pengojë, të rrezikojë apo të vështirësojë peshkimin tregtar.

**Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme**
*Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit*

| **Kategoritë e ndikimeve** | **Ndikimet përkatëse të identifikuara** |
|---|---|
| Ndikimet ekonomike | Bërja e biznesit (qasjen në financa për biznes në peshkatari dhe akuakulturë);<br>Tregtia (ndryshimi **i** flukseve aktuale të importit dhe eksportit për peshk të freskët nga ujërat e ëmbël);<br>Investimet (investime në veprimtari të reja, investimet nga diaspora);<br>Ndikimi në Ndërmarrjet e Vogla Mesme – NVM;<br>Ndikimet ekonomike rajonale në shkëmbimin tregëtarë të peshkut dhe produketeve të peshkut;<br>Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik. |
| Ndikimet shoqërore | Kultura (ruajtja e trashëgimisë kulturore / resurseve peshkore autoktone dhe atyre të rrezikuara; |

| | |
|---|---|
| | Shëndeti dhe siguria publike (jeta e njerëzve dhe cilësia e ushqimit, cilësia e ujërave). |
| Ndikimet mjedisore | Cilësia e ujit (cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe biodiversitetti të këtyre resurseve);<br>Ndryshim në shfrytëzimin e resurseve ujore sipas prioriteteve. |
| Ndikimet në të drejtat themelore | Administrimi i mirë (mënyra e marrjeve të vendimeve nga administrata) i të dhënave me interes për konsumatorin për zinxhirin furnizues me prodhime të peshkut dhe sigurinë e ushqimit. |
| Ndikimi gjinor | Garancitë ligjore dhe dispozitat shoqërore që sigurojnë të drejta të barabarta gjinore. |
| Ndikimet e barazisë sociale | Garancitë ligjore dhe dispozitat shoqërore që sigurojnë të drejta të barabarta të gjitha kategoritë social. |
| Ndikimet tek të rinjtë | Garancitë ligjore dhe dispozitat shoqërore që sigurojnë të drejta të barabarta të gjitha kategoritë sipas moshës përmes ndalimit të angazhimit të fëmijëve nën moshën 16 vjet në aktivitetet të peshkatarisë, sipas Listës nacionale me formar e rrezikshme të punës së fëmijëve. |
| Ndikimet në ngarkesën administrative | Kërkesë për ngritjen e kapaciteteve profesionale në zbatimin e Planit Operacional, vlerësimin e stoqeve të peshkut dhe administrimin e kapaciteteve të tyre si dhe<br>Pëdoruesit e shërbimeve do të kursejnë të paktën 30 - 50% kohë dhe kosto për qasje në shërbim. |
| Ndikimi i NMV-ve | Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit / operatorëve në vlerësimin e stoqeve të peshkut, administrimin e kapaciteteve të stoqeve, regjistrimin e sasisë peshkut të kapur dhe ripeshkëzimin. |

## IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMIT OSE OPCIONEVE TË ARDHSHME

**Opsioni 1** nuk është i dëshirueshëm për shkak të pasojave potencialisht për shkak se situatën aktuale dhe rregullat për peshkatari do të mbeten të njëjta. Nëse ndryshimet nuk ndodhin, korniza ligjore e Kosovës për peshkatari do të mbetej pa një kornizë horizontale që përcakton objektivat e përgjithshme strategjike për peshkatari, ndërsa rregullat do të vazhdojnë të janë të pakompletuara për ruajtjen biologjike të resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet, nuk e ka të rregulluar sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar dhe nuk e ka bazën ligjore për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e resurseve

peshkore. Një qasje e vjetër e bazuar në kontrollin reaktiv, pa mbështetje shkencore dhe bazë ligjore adekuate për të zhvilluar sektorin do të vazhdonte të zbatohet, ashtu që programet e kërkuara të vlerësimit të stoqeve nuk mund të zbatoheshin ligjërisht në zhvillim drejt kontributit në thithjen e fondeve për zhvillimin e sektorit dhe avancimi i politikave të peshkatarisë dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së me qëllim të sigurimit të një niveli të vlerësimit të stoqeve të peshkimit dhe menaxhimin e tyre bazuar në Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (BE) Nr. 1380/2013).

**Opsioni 2** do të kishte përmirësim dhe qartësi të lehtë të dispozitave për peshkatari nga njëra anë, por pa adresuar opsionet e politikave dhe zhvillimet e përcaktuara. Miratimin e versionit të përmirësuar të Ligjit për peshkatarinë, ndërsa pjesët që mungojnë do të plotësohen me legjislacionin dytësor që do të fokusohej në kërkesat më specifike dhe më të detajuara zbatuese për rregullat për mbështetjen financiare për zbatimin e politikave të peshkimit në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës, kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësin e çasjes në fondet e EMFF të BE-së, për standardet e raportimit të të dhënave dhe përditësimi të tyre për stoqet e peshkut dhe akuakulturës, menaxhimi i rezervave për speciet e veqanta dhe fokus i pamjaftueshëm për ruajtjen biologjike të resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e çasjes në ujërat dhe shërbime efikase.

Sipas këtij opsioni, do të këtë përmirësime të kufizuara në ofrimin e shërbimeve për përdoruesit, si në kohë ashtu edhe në kosto.

**Opsioni 3** parashikon krijimin kornizës rregullative të vetëm, horizontal, transparent, gjithëpërfshirës dhe të qartë të bazuar në Politikave të Përbashkëta të Peshkimit për menaxhim të qëndrueshëm, i bazuar në shkencë, inovacion publikuar në Bruksel, datë 21.2.2023, (Politikës së përbashkët të peshkimit CFP). Fushëveprimi, objektivat dhe parimet e CFP-së janë të përcaktuara në Bazë të Rregullores mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr 1380/2013).

CFP parashikon rregulla për ruajtjen biologjike resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet. Gjithashtu përfshinë organizimin e tregut të përbashkët për peshkimin dhe produktet e akuakulturës, politikë strukturore me fonde të dedikuara peshkimit, rregulla specifike për menaxhimin e kapacitetit të flotës së peshkimit, kontrollin e aktivitetit të peshkimit dhe zbatimin. Gjithashtu promovon masa të bazuara shkencore dhe ofron standarde për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave të peshkimit.

Masat për shfrytëzimin e qëndrueshëm të peshkimit janë të rregulluara me Rregulloren (KE) Nr. 1967/2006 (Rregullorja e Mesdheut), ndërkohë që janë përcaktuar masa specifike për stoqet dhe peshkimin nën kompetencën e Peshkimit Rajonal / Organizata e Menaxhimit.

Masat për disa rezervave të specieve të veçanta / të rrezikuara, siç është lloji Ngjala janë të rregulluara me rregullore të veçanta, Rregullorja 1100/2007.

Acqu përmban rregulla specifike për flotën e peshkimit me qëllim që të vendosë ekuilibër mes kapaciteteve të flotës dhe stoqeve të peshkut. Nga shtetet anëtare kërkohet të mbledhin dhe përditësojnë të dhënat që lidhen me të flotën e peshkimit sipas Rregullores së Komisionit (KE) 26/2004. Inspektimi dhe kontrolli janë kryesisht përgjegjësi e shtetit dhe duhet të bëhet në përputhje me Rregulloren e Komisionit (KE) 1224/2009.

Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 përcakton dispozitat për Fondi i Peshkimit Detar (EMFF) për mbështetjen financiare për zbatimin e Politika e Përbashkët Peshkimit (CFP), masat përkatëse në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonat e peshkimit dhe akuakulturës. Për të përfituar nga EMFF, shteteve anëtare të BE-së u kërkohet të miratojnë dokument strategjik dhe programin operativ. Shtetet anëtare duhet të kenë gjithashtu kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për zbatim efikas të Planit Operacional (PO).

Acqu për tregun peshkut, sipas Rregullores (BE) 1379/2013 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian parashikon rregulla për organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe tregut.

Rregulloret për Politikën e Përbashkët të Peshkimit (CFP), rregullojnë edhe çështjet që kanë të bëjnë:

- Objektivat mjedisore, ekonomike dhe sociale të peshkimi dhe mjetet për të menaxhuar këto veprimtari;
- Menaxhim të peshkimit me synim sigurimin e menaxhimit të stoqeve të peshkut me rendiment maksimal dhe qëndrueshëm (MSY) për të siguruar që ndikimet negative të aktiviteteve të peshkimit në ekosistemin të minimizohen;
- Detyrimi e raportimit të sasisë së peshkut / stoqeve nga vitin 2019;
- Zbatimit e planeve shumëvjeçare për menaxhim peshkimit specifik në nivelin e pellgut ujorë;
- Vëmendje ndaj faktorëve ambientit, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe parimet e CFP;
- Vëmendjen ndaj akuakulturës, për zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës, duke përfshirë miratimin e Udhëzimeve strategjike të Komisionit dhe detyrimi i Shteteve Anëtare për të miratuar planet strategjike kombëtare shumëvjeçare për sektorin;
- Reformën e organizimit të përbashkët të tregjeve të peshkimit dhe akuakulturës, me theks në planet e prodhimit dhe marketingut të zhvilluara dhe zbatuar nga organizatat prodhuese;
- Fuqizimin për të bashkëpunuar në mes shteteve anëtare sipas "rekomandimeve të përbashkëta" me masa specifike në nivelin e pellgut ujorë;
- Mundësitë e CFP-së dhe shfrytëzimin e njohurive dhe përvojave të të gjithë palëve të interesuara duke marrë parasysh kushtet e ndryshme në ujërat e BE-së dhe rritja e rajonizimit të CFP;
- Rol më të madh të shkencës, mbledhjen e të dhënave dhe këshillat shkencore;

- Arritjen e ekuilibrit të qëndrueshëm ndërmjet kapaciteteve të flotës së peshkimit dhe peshkimit, dhe mundësitë për të eliminuar kapacitetin e tepërt strukturor të flotës së peshkimit përmes regjistrimit të kapaciteteve të flotës së peshkimit dhe teknologjive të avansuara për monitorim.

Ky opsion mundëson përmirësim optimal në ofrimin e shërbimeve, përmes së cilit të paktën 30 - 50% e kostos dhe kohës do të shkurtohet.

**Zbatimi i MSA:** Republika e Kosovës në proceset integruese në Bashkësi Evropiane është zotuar dhe ka marrë të gjitha obligimet në përafrimin e legjislacionit dhe politikat zhvillimore, lidhur me këtë edhe përgjegjësitë që kanë të bëjnë me peshkatarinë dhe akuakulturën janë fondamentale për zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.

**Përafrimi i politikave me PPB të BE-së:** Marrë parasysh shëndetin e konsumatorit, zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit Republika e Kosovës do të përafrohet me politikat e BE-së sipas Politikave të Përbashkëta të Peshkimit për menaxhim të qëndrueshëm, i bazuar në shkencë, inovacion publikuar në Bruksel, datë 21.2.2023, (Politikës së përbashkët të peshkimit CFP). Fushëveprimi, objektivat dhe parimet e CFP-së janë të përcaktuara në Bazë të Rregullores mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr 1380/2013).

Procesi i  konsultimit synon:

- [Jepni informacionin këtu: Konsultimi paraprak me palët me interes, institucionet akademike, shoqërinë civile dhe organizatat qeveritare dhe jo qeveritare lidhur me nismat e MBPZHR për adresimin e çështjeve të veterinarisë dhe shëndetit publik në përgjithësi përmes legjislacionit dhe opinjonet e tyre lidhur me këtë nismë]
- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, kolona për buxhet duhet të fshihet]
- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, titulli i kolonës 'Afati Indikativ' duhet të ndryshohet në 'Afati kohor']

| **Qëllimi kryesor** | **Grupi i synuar** | **Aktiviteti** | **Komunikimi/njoftimi** | **Afati indikativ** | **Buxheti i nevojshëm** | **Personi përgjegjës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Konsultimi për definimin e problemit; | Të gjitha palët e interesuara; | Takimi i parë publik; | Njoftimi i dërguar përmes postës elektronike zyrtare; | | Projekti i ZKM; | Arsim Memaj Leonora Arifi |
| Konsultimi paraprak ndërministror; | Incitucionet relvante sipas nenit 7 të Rregullores së punës së Qeverisë; | Dërgimi i draft KD; | Përmes postës elektronike zyrtare; | | | |
| Konsultimi publik me shkrim; | Incitucionet relevante, palët e interesuara ; | Publikimi i draft KD në portalin e konsultimeve publike; | Publikimi në ëeb faqe dhe në llogarinë e facebookut të MBPZhR-së dhe njoftimi për mediat vendore; | | | |
| Konsultimi për draftin e parë të KD; | Të gjitha palët e interesuara, veterinerët, institucionet akademike, shoqatat e fermerët mbarështues të kafshëve dhe bizneset | 7 Takime të fokusuara në pjesë të ndryshme të vendit, si dhe një takim me donatorët; | Njoftimi i dërguar përmes postës elektronike zyrtare, përmes web faqeve të komunave, rrjetit social facebook të MBPZHR-së;<br><br>Njoftimi i mediave lokale për përcjelljen e aktivitetit; | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | nga industria pëpunuese e prodhimeve blegtorale, donatorët dhe zyrtarët e komunave. | | Për takimin me donatorë të njoftohen të gjitha mediat qendrore. | | | |

**Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi**
*Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument*

Përmbledhje nga aktivitetet publike për Koncept Dokumentin për Peshakatari dhe Akuakulture

Takimi publik me palët me interes, datë 17.05.2023

Takimi fillestar me palët me interes është realizuar me datë:17.05.2023, ftesat për pjesëmarrje janë dërguar tek këto institucione: Ministria e Kultures Rinis dhe Sportit / Departamenti i sporteve, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktures, Departamenti i Ujerave, Agjencioni per Mbrojtjen e Mjedisit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, Hidroregjioni Prishtina, Fakulteti i Shkencave Natyrore Matematikore, Departamenti i Biologjis, Fakulteti i Bujqesise dhe Veterinaris, Departamenti i sëmundjeve të peshkut, Shoqata e prodhuesve të akuakulturës, Federata e Peshkatareve Sportive Rekreative e Kosoves dhe Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë.
Grupi punues ka prezantuar para pjesëmarrësve fillimin e punës për bazë juridike me qëllim të zhvillimit të peshkatarisë. Të pranishmit janë njoftuar me përmbajtjen e kornizës aktuale ligjore e Kosovës për Peshkatari dhe Akuakulturë, rregulluar me Ligjin për Peshkatari dhe Akuakulturë Nr. 02/L-85, miratuar më 10 Tetor 2006. Republika e Kosovës në proceset integruese në Bashkësi Evropiane është zotuar dhe ka marrë të gjitha obligimet në përafrimin e legjislacionit dhe politikat zhvillimore, lidhur me këtë edhe përgjegjësitë që kanë të bëjnë me peshkatarinë dhe akuakulturën janë fondamentale për zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.
Marrë parasysh shëndetin e konsumatorit, zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit Parlamenti Evropian dhe Këshilli sipas Politikave të Përbashkëta të Peshkimit për menaxhim të qëndrueshëm, i bazuar në shkencë, inovacion publikuar në Bruksel, datë 21.2.2023, (Politikës së përbashkët të peshkimit CFP). Fushëveprimi, objektivat dhe

parimet e CFP-së janë të përcaktuara në Bazë Rregullorja mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr 1380/2013).
Rerferuar Rregullores bazë për Politikën e Përbashkët të Peshkimit (CFP), Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr. 1380/2013 me këtë koncept dokument palët me interes nga peshkakatria dhe akuakultura janë informuar edhe për çështjet të cilat rregullohen, që kanë të bëjnë me:

- Arritjen e objektivave mjedisore, ekonomike dhe sociale të peshkimi dhe mjetet për të menaxhuar këto veprimtari;
- Ybatimit e planeve shumëvjeçare për menaxhim peshkimit specifik në nivelin e pellgut ujorë;
- Faktorët ambientit, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe parimet e CFP;
- Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës;
- Reformën e organizimit të tregjeve të peshkimit dhe akuakulturës, me theks në planet e prodhimit dhe marketingut të zhvilluara dhe zbatuar nga organizatat prodhuese;
- Bazën e nevojshme ligjore për trajtimin e peshkimit të pa rregulluar;
- Rol më të madh të shkencës dhe
- E peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar.

2. Konsultime paraprake ndërministrore, datë: xx-xx /xx/ 2023

**Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve**

**Opsioni 1** nuk është i dëshirueshëm për shkak të pasojave nga situata aktuale, ndërsa rregullat për peshkatari do të mbeten të njëjta. Nëse ndryshimet nuk ndodhin, korniza ligjore e Kosovës për peshkatari do të mbetej pa kornizë që përcakton objektivat e përgjithshme strategjike për peshkatari, ndërsa rregullat do të vazhdojnë të jenë të pakompletuara. Mos ndryshimi i gjendjes aktuale, sipas këtij opsioni, do të vazhdoj që objektivat për ruajtjen biologjike të resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet, mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar dhe për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e resurseve peshkore të mbetet i njejtë.

**Opsioni 2** do të kishte përmirësim dhe qartësi të lehtë të dispozitave për peshkatarinë nga njëra anë, por pa adresuar opsionet e politikave. Miratimin e versionit të përmirësuar të Ligjit për peshkatarinë, do të plotësohen me legjislacionin dytësor që do të fokusohej në rregullat për mbështetjen financiare për zbatimin e politikave të peshkimit në lidhje

me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës, kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësinë e qasjes në fondat e EMFF të BE-së. Nëse zgjidhet ky opsion, do të humbet mundësia në rregullimin e çështjeve: mjedisore, ekonomike dhe sociale të peshkimi, zbatimit të planeve shumëvjeçare për menaxhim peshkimit specifik në nivelin e pellgut ujorë, faktorët e ambientit në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe parimet e CFP, organizimit të tregjeve të peshkimit dhe akuakulturës të zhvilluara dhe zbatuar nga organizatat prodhuese dhe rol më të madh të shkencës në peshkatari.

**Opsioni 3** parashikon krijimin e kornizës rregullative gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet ndërkombëtare, Rregullorja bazë për Politikën e Përbashkët të Peshkimit (CFP), Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) Nr. 1380/2013 të fokusuar objektivat mjedisore, ekonomike dhe sociale të peshkimi dhe mjetet për të menaxhuar këto veprimtari, sigurimin e menaxhimit të stoqeve të peshkut me rendiment maksimal dhe qëndrueshëm (MSY) për të siguruar që ndikimet negative të aktiviteteve të peshkimit në ekosistemin detar të minimizohen; detyrimi e raportimi i sasisë së peshkut / stoqeve nga vitin 2019; zbatimit të planeve shumëvjeçare për menaxhim të peshkimit specifik në nivelin e pellgut ujorë; vëmendje ndaj faktorëve të ambientit, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe parimet e CFP; vëmendjen ndaj akuakulturës për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës, duke përfshirë miratimin e Udhëzimeve strategjike të Komisionit dhe detyrimi i Shteteve Anëtare për të miratuar planet strategjike kombëtare shumëvjeçare për sektorin; reformën e organizimit të përbashkët të tregjeve të peshkimit dhe akuakulturës, me theks në planet e prodhimit dhe marketingut të zhvilluara dhe zbatuar nga organizatat prodhuese; fuqizimin për të bashkëpunuar në mes shteteve anëtare sipas "rekomandimeve të përbashkëta" me masa specifike në nivelin e pellgut ujorë; mundësitë e CFP-së dhe shfrytëzimin e njohurive dhe përvojave të të gjithë palëve të interesuara, duke marrë parasysh kushtet e ndryshme në ujërat e BE-së dhe rritja e rajonizimit të CFP; rol më të madh të shkencës, mbledhjen e të dhënave dhe këshillat shkencore dhe arritjen e ekuilibrit të qëndrueshëm ndërmjet kapaciteteve të flotës së peshkimit dhe mundësitë për të eliminuar kapacitetin e tepërt strukturor të flotës së peshkimit.

Opsioni i propozuar, opsioni 3, krijimin e kornizës rregullative gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet ndërkombëtare do të ketë ndikim më të qartë në politikën dhe objektivat mjedisore, ekonomike dhe sociale të peshkimi dhe mjetet për të menaxhuar këto veprimtari; zbatimit e planeve shumëvjeçare për menaxhim të peshkimit specifik në nivelin e pellgut ujorë; faktorët ambientit, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe parimet e CFP; zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës; reformën e organizimit

të tregjeve të peshkimit dhe akuakulturës në planet e prodhimit dhe marketingut të zhvilluara dhe zbatuar nga organizatat prodhuese dhe rol më të madh të shkencës.

Ky opsion preferohet, edhe për shkak se mundëson edhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve.

**Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme**

Për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Ligji për peshkatarinë dhe akuakulturën dhe adresimin e disa shkaqeve të problemit, Opsioni 3, parasheh:

- Krijimin e kornizës rregullative gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në përafrimin me Politikën e Përbashkët të Peshkimit (CFP), Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) Nr. 1380/2013;
- Krijimin e kornizës rregullative për qasje në Fondin e Peshkimit (EMFF) për mbështetjen financiare në zbatimin e Politika e Përbashkët Peshkimit (CFP);
- Rritjen e të hyrave buxhetore;
- Ofron fleksibilitet më të madh dhe barrë administrative më të ulët;
- Politikat për përmirësimin e gjendjes në peshkatari dhe akuakulturë dhe do të kontribuojnë në vlerën më të lartë të prodhimit dhe konkurrencës;
- Zbatimi i politikave dhe objektivave mjedisore, do të reduktonte ndotjen dhe arritja e standardeve të qëndrueshme mjedisore;
- Reduktimi i peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar;
- Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës.

Plani i zbatimit për Opsionin 3

| PLANI I ZBATIMIT TË OPSIONIT 3 | | |
|---|---|---|
| **Qëllimi i Politikës** | Opsioni 3 parashikon krijimin kornizës rregullative gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në krijimin e kornizës rregullative gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në përafrimin me Politikën e Përbashkët të Peshkimit (CFP), Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE), Nr. 1380/2013. Ky opsion do të ketë ndikim më të qartë në politikën e zhvillimit të peshkatarisë dhe akuakulturë, ofron fleksibilitet më të madh dhe barrë administrative më të ulët; | **Shifra e kostos së pritur** |
| **Objektivi strategjik** | **- Avancimi i politikave të zhvillimit të peshkatarisë dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së me qëllim të sigurimit të një niveli të vlerësimit të stoqeve të peshkimit dhe menaxhimin e tyre bazuar në Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (BE), Nr. 1380/2013);** | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Produkti, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës | | | | | | | | |
| **Objektivi Specifik Nr.1 Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit;** | **Produkti 1.1** | **Numri i inspektimeve** | | | | | | | |
| | | | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Institucioni /departamenti përgjegjës | |
| | | **Aktiviteti 1.1.1** Rekrutimi i tre inspektorëve për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit; | X | 100 | 150 | 200 | 200 | MBPZHR dhe AUV | |
| | **Produkti 1.2** | **Tre (3) trajnime të inspektorëve dhe dy (2) trajnime të stafit në nivelin qëndror** | | | | | | | |
| | | **Aktiviteti 1.2.1** Trajnimi i inspektorëve; | X | X | | | | | |
| | | **Aktiviteti 1.2.2** Organizimi i trajnimit për inspektorëve dhe stafit në nivelin qendror; | | X | | | | MBPZHR | |
| | | **Aktiviteti 1.2.3** | | | X | | | MBPZHR | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Organizimi i trajnimit për zyrtar në nivel qëndrorë për vlerësimin e stoqeve të peshkut; | | | | | | | |
| **Objektivi Specifik Nr.2**<br>•Avancimi i kornizës legjislative dhe rregullative;<br>•Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e politikave zhvillimore në peshkatari dhe akuakulturë; | **Produkti 2.1** | **Koordinimi më i mirë institucional në mes të nivelit qendror, lokal, institucioneve shkencore dhe shoqatave profesionale (MBPZHR, komunat dhe institucionet tjera relevante);** | | | | | | | |
| | | **Aktiviteti 2.1.1** Organizimi takimeve të përbashkëta për harmonizimin e aktiviteteve dhe politikave sektoriale bazuar në ligje; | X | X | X | X | X | MBPZHR | |
| | | Aktiviteti 2.1.2 Zbatimi i planeve shumëvjeçare për menaxhim peshkimit specifik në nivelin e | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pellgut ujotë;<br><br>Zbatimi i planeve ambiental, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe parimet e CFP; | | | | | | | |
| **Objektivi Specifik Nr.3** | **Produkti 3.1** | **Kampanja për përmirësimin e menaxhimit të të dhënave dhe raportimi.** | | | | | | | |
| •Harmonizimi i sistemit të bazës së të dhënave si shërbim sipas standardeve të BE-së; | | **Aktiviteti 3.1.1** Përgatitja e sistemit të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave sipas standardeve të BE-së; | | | X | X | X | MBPZHR Operatorët ekonomik që merren me eshkim dhe akuakultur peshkatarët sportivë rekreativë dhe institucionet kërkimore shkencore; | |
| | | **Aktiviteti 3.1.2** Integrimi i bazës nacionale | | | | X | X | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në sistemin ndërkombëtar të raportimit të të dhënave. | | | | | | | |

Për zhvillimin e peshkatarisë dhe akuakulturës, Opsioni 3, parasheh hartimin e ligji të ri për peshkatarinë dhe akuakulturën. Për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Ligji për peshkatarinë dhe akuakulturën dhe adresimin e disa shkaqeve të problemit, Opsioni 3, parasheh:

- Krijimin kornizës rregullative gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në përafrimin me Politikën e Përbashkët të Peshkimit (CFP), Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr. 1380/2013;
- Krijimin kornizës rregullative për qasje në Fondin e Peshkimit (EMFF), për mbështetjen financiare në zbatimin e Politikave të Përbashkëta të Peshkimit (CFP);
- Ofron fleksibilitet më të madh dhe barrë administrative më të ulët;
- Politikat për përmirësimin e gjendjes në peshkatari dhe akuakulturë;
- Zbatimi i politikave dhe objektivave mjedisore, do të reduktonte ndotjen dhe arritja e standardeve të qëndrueshëme mjedisore;
- Reduktimi i peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar;
- Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës.

Projektligji i ri do të përcaktojë:

- Krijimin kornizës rregullative gjithëpërfshirës në përputhje me standardet ndërkombëtare: Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli (BE) Nr. 1380/2013; Masat e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit dhe stoqeve të peshkut, menaxhimi e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara (Rregullorja (KE) Nr. 1967/2006, Qasjes në fondat e EMFF të BE-së (Rregullorja (BE), Nr. 508/2014 përcakton dispozitat për Fondin Evropian të Peshkimit Detar (EMFF) për mbështetjen financiare për zbatimin e CFP, Standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe

tregut për peshkun dhe prodhimet akuatike (Rregullores (BE), 1379/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe parashikon rregulla për organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacionet për konsumatorët, rregullat e konkurrencës dhe tregut), Peshkimi të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar (Rregullorja 1005/2008, datë 29 shtator 2008).

Ligji i ri për peshkatarinë dhe akuakulturën do të përfshijë elementet themelore si në vijim:

- Ruajtjen biologjike të resurseve ujore, kufizimi i ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujërat dhe burimet;
- Përkufizime / shprehjet e përdorura për të kuptuar parimet e BE-së për peshkatari dhe akuakulturë për transpozimin dhe zbatimin e mëtejshëm të kornizës ligjore të BE-së;
- Menaxhimi specifik për masat e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit dhe stoqeve të peshkut;
- Rregulla për menaxhimin e rezervave për speciet e veqanta apo të rrezikuara;
- Standardet për të dhënat dhe përditësimi i të dhënave për kapacitetin specifik-teknik të flotës së peshkimit;
- Rregullat për mbështetjen financiare për zbatimin e politikave të peshkimit në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të peshkimit dhe akuakulturës;
- Kërkesat ligjore për bashkëpunim dhe mundësin e çasjes në fondat e EMFF të BE-së;
- Kërkesat ligjore për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës, duke përfshirë miratimin e planit strategjik kombëtare shumëvjeçare për sektorin;
- Bazën ligjore, sipas praktikave të shtetetve anëtare të BE-së për kapacitetet e nevojshme të menaxhimit dhe kontrollit administrativ për zbatim efikas të OP;
- Rregulla për organizatat profesionale;
- Rregulla për standardet e përbashkëta të marketingut, informacioni i konsumatorëve, rregullat e konkurrencës dhe tregut për peshkun dhe prodhimet akuatike;
- Rregullat për sistemin/ mekanizmin për parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar;
- Rregullat për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e resurseve peshkore.

**Plani i zbatimit për Opsionin 2**

| PLANI I ZBATIMIT PËR OPSIONIN 2 | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi i Politikës** | -Përmirësim dhe qartësi të lehtë të dispozitave për peshkatari dhe akuakulturë, pa adresuar opsionet e politikave dhe zhvillimore për peshkatari dhe akuakultur. | | | | | | | |
| **Objektivi Strategjik** | Krijimi i mundësive për të adresuar mangësitë në peshkatari dhe akuakultur. | | | | | | | |
| **Objektivi specifik 1:**<br>**Avancimi i kornizës legjislative dhe rregullative për peshkatari dhe akuakultur** | **Produkti 1.1** | **Ligji për peshkatari dhe akuakultur i plotësuar** | | | | | | |
| | | | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | Institucioni/Departamenti Përgjegjës |
| | | **Aktiviteti 1.1**<br>Plotësim ndryshimi i ligjit; | | X | | | | MBPZHR |
| | | **Aktiviteti 1.3**<br>Hartimi i akteve nënligjore të dala nga plotësim ndryshimi i ligjit; | | | X | x | | MBPZHR |
| | | | | | | | | |
| | **Produkti 1.2** | **Përafrimi i bazë e të dhënave për peshkatari dhe akuakultur** | | | | | | |
| | | **Aktiviteti 1.3.1**<br>Krijimi dhe përditësimi i të dhënave duke respektuar standardet e BE-së për të dhënat për | | | X | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | peshkatari dhe akuakultur; | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| **Objektivi specifik 2:** **Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit** | **Produkti 2.1** | **Numri i inspektimeve** | | | | | | |
| | | **Aktiviteti 2.1.1** Rekrutimi inspektorëve shtesë për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit; | | X | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | **Produkti 2.2** | **3 trajnime për inspektorët** | | | | | | |
| | | **Aktiviteti 2.2.1** Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve; | | X | X | X | X | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |

**Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me tri opsionet**
**[Jepni një paraqitje të shkurtër narrative të tri opsioneve. Gjithashtu, paraqitni opsionin e zgjedhur dhe arsyet kryesore përse është zgjedhur.]**

**Krahasimi i opsioneve**

| **Metoda e krahasimit:** | | | |
|---|---|---|---|
| **Ndikimet relevante pozitive** | **Opsioni 1**<br>**Nuk ka ndryshime** | **Opsioni 2**<br>**Përmirësimet e kornizës aktuale ligjore** | **Opsioni 3**<br>**Korniza e re ligjore për peshkatari** |
